

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 1

Çështje procedurale

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 E enjte, 26 tetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Seancë e apelit]

4 [Apeluesi hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 13.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirëdita

7 dhe mirë se vini të gjithë.

8 Z. Sekretar i Gjykatës, a mund të paraqisni lëndën ju

9 lutem.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita. Kjo është

11 çështja KSC-CA-2023-02, Prokurori i Specializuar kundër Salih

12 Mustafës. Faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

14 Faleminderit, z. Sekretar.

15 Konstatoj që z. Mustafa është i pranishëm në sallën e

16 gjyqit.

17 Z. Mustafa, a mund ta ndiqni procedurën në një gjuhë që e

18 kuptoni?

19 APELUESI: Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

21 Faleminderit. Do t'ju kërkoj tani palëve dhe Mbrojtësit të

22 Viktimave që të prezantohen, duke filluar me Mbrojtësin e z.

23 Mustafa.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, znj. Kryegjykatëse.

25 Mbrojtja përfaqësohet nga unë, Julius von Bone, Avokat

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 2

Çështje procedurale

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 Mbrojtës; ndihmësit e mi, asistentët e mi janë z. Fatmir Pelaj
2 dhe z. Avdi Mehmeti. Faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
4 Faleminderit.

5 Tani, Zyra e Prokurorit të Specializuar.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
7 Mirëdita të gjithëve atyre që janë jashtë kësaj salle gjyqi.

8 Prokuroria përfaqësohet sot nga Prokurorja e Specializuar
9 Kimberly West, Prokurori i Lartë Clare Lawson, Nico Baarlink,
10 Ndihmësprokuror, Zyrtari ligjor Nathan Quick, Menaxherja e
11 Lëndës Julie Mann. Sot në sallën e gjyqit kemi të pranishëm
12 edhe Jaden Harding, stazhier dhe Cezary Michalczuk, Prokuror i
13 ZPS-së.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Tani
15 kthehem te Mbrojtësja e Viktimave.

16 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës, dhe
17 mirëdita, mirëdita të gjithëve në sallën e gjyqit dhe jashtë
18 sallës. Viktimat pjesëmarrëse përfaqësohen sot nga
19 bashkavokati im, Brechtje Vossenber, dhe unë, Annie Pues,
20 avokate.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
22 Faleminderit.

23 Për procesverbal, jam Michele Picard, Kryegjykatësja në
24 këtë lëndë dhe kolegët e mi janë në krahun tim të djathtë, Kai
25 Ambos dhe në të majtë Nina Jorgensen.

1 Kjo seancë ka të bëjë me -- e apelit kundër konstatimit
2 të Trupit Gjykses në lidhje me përgjegjësinë e z. Mustafa,
3 komandant i njësimit gueril BIA, një njësit i Ushtrisë
4 Çlirimtare të Kosovës ose UÇK, në një varg ngjarjesh midis
5 përafërsisht 1 prillit dhe 19 prillit 1999 në kompleksin e
6 ndalimit në Zllash ose shkurtimit KNZ.

7 Në aktgjykimin e vet të 16 dhjetorit 2022 Trupi Gjykses
8 konstatoi se të paktën gjashtë personave iu hoq liria nga
9 anëtarë të BIA-s nën kontrollin dhe pushtetin e të akuzuarit
10 se të ndaluarit në KNZ, u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe
11 poshtëruese dhe keqtrajtuuan rregullisht, si fizikisht ashtu
12 edhe psikologjikisht, me synim të marrjes së informatave apo
13 deklaratave pranuese duke i ndëshkuar, frikësuar, shtrënguar
14 dhe diskriminuar ata për arsye politike. Dhe përfundimisht një
15 person vdiq si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve që i
16 atribuohen të akuzuarit dhe vartësve të tij në BIA.

17 Trupi Gjykses e shpalli të akuzuarin fajtor në lidhje me
18 katër pikat e aktakuzës për kryerje të krimeve të luftës,
19 përkatësisht:

20 - Kryerje të drejtpërdrejtë të krimit të luftës të torturës
21 sipas pikës 3, dhe

22 - Për kryerje si pjesë e ndërmarrjes kriminale të
23 përbashkët ose NKP 1, të krimeve të luftës të ndalimit
24 arbitrar, pika 1; torturë, pika 3; dhe vrasje e paligjshme,
25 pika 4.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 4

Çështje procedurale

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 Trupi Gjykses e shpalli të akuzuarin të pafajshëm për
2 krimin e luftës së trajtimit mizor, sipas pikës 2, duke
3 gjykuar se ishte "mbuluar tërësisht" nga akuza për krimin e
4 luftës të torturës.

5 Trupi Gjykses dënoi z. Mustafa me dënime në vete prej 10
6 vjet burgim për krimin e luftës të ndalimit arbitrar, 22 vjet
7 burgim për krimin e luftës të torturës dhe 25 vjet burgim për
8 krimin e luftës të vrasjes së paligjshme.

9 Trupi Gjykses pastaj dha një dënim të njësuar me 26 vjet
10 burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

11 Z. Mustafa ka paraqitur 51 pika të apelit kundër
12 aktgjykimin të Trupit Gjykses. Ai parashtron se Trupi Gjykses
13 ka kryer një numër gabimesh ligjore dhe faktike, si dhe gabime
14 në përcaktimin e dënimit. Z. Mustafa kërkon që Paneli i Apelit
15 të shfuqizojë vendimin e fajësisë dhe ta shpallë atë të
16 pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e aktakuzës ose t'ia
17 kthejë çështjen Trupit Gjykses. Si alternativë z. Mustafa
18 kërkon që Paneli i Apelit të ulët dënimin e tij.

19 ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave kundërshtojnë apelin
20 dhe kërkojnë që Paneli i Apelit ta hedhë poshtë atë, tërësisht
21 ose pjesërisht.

22 Në përputhje me urdhrin për caktimin e datës së kësaj
23 seance të lëshuar më 17 gusht 2023, Paneli i Apelit do të
24 dëgjojë sot dhe nesër parashtrime gojore në vijim të apelit të
25 dorëzuar nga z. Mustafa, përgjigjeve të ZPS-së dhe Mbrojtjes

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 5

Çështje procedurale

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 së Viktimave dhe kundërpërgjigjes së z. Mustafa.

2 Në këtë drejtim Paneli i Apelit thekson si vijon në
3 lidhje me parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave. Paneli
4 rikujton se në Vendimin mbi Modalitetet e Pjesëmarrjes së
5 Viktimave në Procedurën e Apelit, të datës 15 shkurt 2023,
6 Paneli i Apelit vendosi që viktimat që kishin marrë pjesë në
7 procedurën paraprake dhe gjykim mund të merrnin pjesë në
8 procedurën e apelit me kusht që pjesëmarrja e tyre të
9 kufizohet në aspekte që dalin nga pikat e ngritura të apelit.

10 Gjithashtu në përputhje me ligjin, Paneli i Apelit
11 përcaktoi se Mbrojtësja e Viktimave mund të bëjë parashtrime
12 me gojë dhe shkrim para Panelit nëse përshkruan shprehimisht
13 se si parashtrimet lidhen me interesat personale të viktimave
14 pjesëmarrëse.

15 Gjatë kësaj seance Paneli do të lejojë në përgjithësi
16 parashtrime gojore nga Mbrojtësja e Viktimave. Sidoqoftë,
17 Paneli thekson se në fund do t'i marrë parasysh në bazë të
18 themelsisë së tyre ato parashtrime të Mbrojtjes së Viktimave
19 që janë në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Vendimin
20 mbi Modalitetet e Pjesëmarrjes së Viktimave në Procedurën e
21 Apelit.

22 Tani do të jap një përmbledhje të mënyrës se si do të
23 veprohet në këtë seancë.

24 Dëshiroj t'u rikujtoj palëve dhe pjesëmarrëseve se
25 procesi i apelit nuk është gjykim i ri dhe të mos përsërisin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 6

Çështje procedurale

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 argumente të tyre të paraqitura në gjykim. Argumentet e tyre
2 duhet të kufizohen në gabime të pretenduara ligjore që e bëjnë
3 aktgjykimin të pavlefshëm, gabime të pretenduara faktike që
4 kanë shkaktuar gabim gjyqësor ose gabime të pretenduara në
5 përcaktimin e dënimit.

6 Gjatë seancës avokatët mund të paraqesin argumentet e
7 tyre në cilën çdo renditje që e konsiderojnë të përshtatshme.
8 Palët dhe pjesëmarrësit duhet t'i paraqesin parashtrimet e
9 tyre në mënyrë të saktë, të qartë dhe përmbledhëse dhe të
10 japin referenca të sakta për materialet që mbështesin
11 argumentet e tyre gojore.

12 Paneli rikujton gjithashtu se në Urdhrin për Përgatitjen
13 e Seancës së Apelit të datë 12 tetor 2023, Paneli ftoi palët
14 dhe pjesëmarrësit sipas rastit të trajtojnë disa pyetje
15 çështje spec -- konkrete në lidhje me vendimin e fajësisë së
16 z. Mustafa për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme dhe
17 për dënimin që dha Trupi Gjykses në këtë çështje gjyqësore.
18 Gjykatësit, natyrisht mund të bëjnë pyetje të tjera shtesë,
19 qoftë gjatë parashtrimeve gojore ose pas tyre ose edhe në fund
20 të seancës së apelit. Paneli i Apelit gjithashtu thekson se
21 është njohur me dosjet e palëve dhe rrjedhimisht u kërkon
22 atyre që të mos përsërisin fjalë për fjalë dhe as të japin
23 përmbledhje të gjata të argumenteve të paraqitura me shkrim,
24 përveç nëse kjo është absolutisht e domosdoshme.

25 Dëshiroj gjithashtu t'ju kujtoj të gjithëve disa rregulla

1 që duhet të respektohet në çdo kohë me qëllim që procesi në
2 sallën e gjyqit të jetë efikas dhe procesverbali i saktë.

3 Kini parasysh, ju lutem, se është e nevojshme të kemi
4 përkthim dhe transkriptim të saktë që shpesh kërkon pak më
5 shumë kohë gjatë shkëmbimeve mes folësve. Mos harroni, ju
6 lutem, që të përdorni mikrofonat. Kjo seancë transkriptohet në
7 kohë reale dhe do të pasqyrohet në transkript që do të vihet
8 në dispozicion të palëve dhe pjesëmarrësve si dhe publikut.
9 Për rrjedhojë do t'i kërkoja secilit prej jush që të flisni
10 ngadalë dhe në mënyrë të qartë dhe të lini disa sekonda bosh
11 mes folësve. I kujtoj gjithashtu mbrojtësit që të japë njoftim
12 paraprak në qoftë se ndonjë nga parashtrimet kërkon zbulimin e
13 materialit konfidencial edhe pse është konfidencial apo ex
14 parte me qëllim që të kalojmë në seancë private ose të
15 mbyllur.

16 Dëshiroj t'ju rikujtoj gjithashtu Mbrojtësve që të
17 tregojnë kujdes të veçantë dhe të mos zbulojnë ndonjë
18 informacion që mund të identifikojë dëshmitarë të mbrojtur.

19 Në përputhje me vendimin për caktimin e datës së seancës
20 lëshuar më 17 gusht 2023, i cili përcakton agjendën për sot,
21 kjo seancë do të zhvillohet si në vijim: Sot do të dëgjojmë
22 parashtrimet nga avokati i z. Mustafa, që do zgjasë 1 orë e
23 gjysmë. Pas një pushimi 30 minutash ZPS-ja do t'i përgjigjet
24 z. Mustafa për 1 orë e gjysmë.

25 Nesër në mëngjes, duke filluar në 09.30, Mbrojtësja e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 8

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 Viktimave do t'i përgjigjet z. Mustafa për 1 orë. Mbrojtësi i
2 z. Mustafa pastaj do të ketë 20 minuta për t'u
3 kundërpërgjigjur dhe pas kësaj z. Mustafa -- do t'i jepet
4 mundësia që të bëjë që të japë mbajë një fjalë apo vërejtje
5 personale të shkurtë Panelit.

6 Dëshiroj tani të ftoj avokatin e z. Mustafa që të
7 fillojë. Keni tani kohë deri në 15.10, që i bie 1 orë e 30
8 minuta -- 1 orë e 10 minuta [sipas përkthimit].

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, të nderuar
10 Gjykatës. Faleminderit shumë.

11 Të nderuar Gjykatës. Më 16 dhjetor 2022 Trupi Gjykses I
12 nxori aktgjykimin në rastin kundër Salih Mustafës. Z. Sali
13 Mustafa akuzohej për katër akuza: Ndalim arbitrat, trajtim
14 mizor, torturë dhe vrasje.

15 Ai u shpall i pafajshëm për akuzën numër 2, për trajtim
16 mizor. Ndërsa për ndalim arbitrar akuza 1 z. Mustafa u shpall
17 fajtor dhe u dënua me dhjetë vjet burgim. Për akuzën 3 të
18 torturës, Trupi Gjykses e dënoi atë me 22 vjet burgim. Dhe së
19 fundmi për akuzën, pikën e akuzës 4, vrasje, ai u dënua me 25
20 vjet burgim. Pas përcaktimit të këtyre dënimeve, Trupi Gjykses
21 caktoi dënimin e njehsuar 26 vjet burgim.

22 Në emër të z. Mustafa, Mbrojtja parashtroi njoftim për
23 apel, dorëzoi Njoftimin për Apel më 2 shkurt kundër
24 aktgjykimin dhe dënimin të z. Mustafa. Mbrojtja kërkon
25 shfuqizimin e dënimeve për akuzën 1, 3 dhe 4 dhe kërkon

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 9

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 shpallje të pafajshme për secilën akuzë apo Gjykata të kthejë
2 çështjen për gjykim te Trupi Gjykues dhe propozojmë që ose
3 çështja të kthehet për përputhshmëri me kushtetutshmërinë. Dhe
4 përfundimisht kërkojmë që shpalljet e dënimit të -- në qoftë
5 se këto dënime konfirmohen që të bëhet një ulje e dënimit.

6 Mbrojtja parashtroi dosjen e apelit dhe versionin e
7 korrigjuar të datës 2 maj 2023. Aty formulohen bazat e apelit,
8 pikat e apelit. Mbrojtja ka formuluar 9 pika apeli me 51
9 nënpika. 6 prej tyre ishin të njëjta apo pothuajse të njëjta
10 dhe me pikat e tjera të cilat përmenden në dosjen e apelit.

11 Mbrojtja mban, qëndron në pozicionin, qëndrimin të tyre
12 që ka paraqitur në versionin e korrigjuar të dosjes së apelit.
13 Z. Mustafa dhe Mbrojtja besojmë fuqimisht se aktgjykimi është
14 i gabuar dhe dënimi i caktuar i gabuar. Edhe nëse apeluesi po
15 të ishte shpallur fajtor, përsëri edhe në këtë rast dënimi i
16 përcaktuar është i disproporcionuar dhe tepër i ashpër.

17 Në afatin kohor që është caktuar nga Dhoma e Apelit,
18 Mbrojtja do të nënvizojë disa pika të apelit dhe to sjellë
19 vëmendje, do të sjellë në vëmendjen e kësaj Dhome.

20 Pika e parë është 1J, standardi për të vlerësuar
21 dëshmitarët dhe dëshminë e tyre.

22 Trupi Gjykues gaboi, gaboi sepse nuk zbatoi standarde të
23 drejta dhe të paanshme apo nuk zbatoi standardet që i kishte
24 vetëcaktuar. Në vlerësimin e provës dhe të dëshmitarëve të
25 Mbrojtjes dhe të Mbrojtjes dhe Mbrojtja e cila ishte në favor

1 - dhe provat që ishin në favor të Mbrojtjes kur këto kjo
2 dëshmi jepej nga dëshmitarë të Mbrojtjes.

3 Trupi Gjykses përdori faktorë që i kishte vetëcaktuar, e
4 ka bërë këtë në paragrafin 35 të aktgjykimit. Këto faktorë
5 ishin standarde për të vlerësuar besueshmërinë dhe
6 mbështetshmërinë e dëshmitarëve. Në paragrafin 50 më tej të
7 aktgjykimit, Gjykata përshkruan atmosferë frike dhe frikësimi
8 të dëshmitarëve në përgjithësi.

9 Sa i përket pikës 1J, Mbrojtja nga shpjeguar në dosjen e
10 apelit se Trupi Gjykses është mbështetur vetëm dhe për një
11 pjesë të madhe në dy kriter subjektiv që mund të gjendet në
12 pikën VIII dhe IX të vetëcaktuara nga Trupi Gjykses. Kriteret
13 janë renditur në paragrafin 35 të aktgjykimit.

14 Në veçanti Trupi Gjykses të shfaqë hezitim ose mosdëshirë
15 që të marrë si faktike dëshminë e dëshmitarëve të cilët
16 mohonin ekzistencën e vendndalimit në kompleksin e Zllashit.
17 Në çdo rast kur dëshmitarët jepnin dëshmi të tillë, Trupi
18 Gjykses papritmas u tregua jashtëzakonisht i kujdesshëm me
19 provat, me dëshmi të tilla dhe me personat që jepnin këto
20 dëshmi.

21 Kur personat dëshmonin për mospranimin e vendndalimit,
22 mosekzistencën apo jepnin dëshmi se asnjë person nuk është
23 keqtrajtuar në kompleksin e Zllashit, pastaj natyrisht kjo do
24 të çonte në faktin se akuzat nuk mund të vërtetoheshin përtej
25 dyshimit të arsyeshëm. Dëshmi të tilla u vlerësuan çdo herë me

1 kujdes të jashtëzakonshëm apo këtu u kundërshtuan duke
2 përdorur dëshmi të tre dëshmitarëve inkriminues.

3 Në aktgjykim, për sa i përket dëshmitarëve të Mbrojtjes,
4 Mbrojtja parashtron se me sa duket vetëm dy prej këtyre
5 kritereve janë zbatuar te dëshmitarët të cilët dhanë dëshmi
6 për mosekzistencën e pranisë së njerëzve të mbajtur të ndaluar
7 në kompleksin e Zllashit. Tetë dëshmitarë dhanë dëshmi që nuk
8 kishte vendndalim dhe apo keqtrajtim të njerëzve në kompleksin
9 e Zllashit. Qartësisht kjo ndihmon që të vërtetohet se akuzat
10 nuk mund të vërtetohen.

11 Pra, për shembull, kur Fatmir Sopi, dëshmitari i ZPS-së
12 dhe komandant i UÇK-së, i cili e njihte kompleksin në fjalë,
13 dëshmoi se aty nuk kishte patur njerëz të ndaluar apo të
14 keqtrajtuar në Zllash, Trupi Gjykues papritmas iu referua
15 faktit se dëshmitarët e tjerë të ZPS-së kishin dhënë dëshmi të
16 kundërt dhe kjo gjendet në paragrafin 119-122 i aktgjykimit.

17 Ka qenë vazhdimisht qëndrimi i Mbrojtjes se viktimat mund
18 të jenë mbajtur të ndaluar, por sigurisht nuk janë mbajtur të
19 ndaluar në atë vend. Dhe as nga BIA, duke qenë se kjo njësi
20 nuk kishte autoritet që të bënte një gjë të tillë.

21 Qasja e Trupit Gjykues ka qenë sistematikisht ajo që në
22 momentet që një dëshmitar jepte dëshmi se nuk kishte patur
23 njerëz të ndaluar apo të keqtrajtuar në atë vend në atë rast,
24 Trupi Gjykues hetonte personin apo sugjeronte ndonjë motiv që
25 ai mund të kishte për të folur në këtë mënyrë. Ose Trupi

1 Gjykues thjesht i ka konsideruar tregimet e tyre si të
2 pabesueshme.

3 Një tjetër shembull i personit të tillë do të ishte z.
4 Veseli, edhe ky dëshmitar i ZPS-së dhe komandant i UÇK-së që
5 njihte edhe ky kompleksin. Ai dëshmoi që aty nuk ka patur
6 njerëz të ndaluar apo të keqtrajtuar në Zllash. Trupi Gjykues
7 në paragrafin 128, pothuajse mori atë që ishte më parë, për
8 vlerësimet e tyre të mëparshme lidhur me pamundësinë që
9 tregimi i tij ishte i pamundur, lidhur me çështjen e
10 mospranisë së ndalimit të njerëzve apo që ata mund të jenë
11 keqtrajtuar në atë kompleks.

12 Trupi Gjykues vlerësoi në paragrafin 129 se z. Sejdi
13 Veseli, strategjikisht drejtoi dëshminë e tij për të mbrojtur
14 të akuzuarin, UÇK-në dhe reputacionin e saj. Kjo nuk ka kuptim
15 për Mbrojtjen, në sytë e Mbrojtjes, sepse nuk ka asnjë tregues
16 se si z. Veseli në mënyrë strategjike orientoi dëshminë e tij.
17 Z. Veseli thjesht iu përgjigj pyetjeve që i parashtroheshin
18 nga palët dhe Trupi Gjykues. Fakti që z. Veseli akoma sot
19 vazhdon të respektojë UÇK-në dhe kauzën e saj apo
20 bashkëluftëtarët e tij është faktor që vlen për gjithë
21 njerëzit në Kosovë pothuajse, sepse UÇK-ja ishte ajo që luftoi
22 për pavarësinë e Kosovës. Në fakt do të ishte shumë e pagjasë
23 që z. Veseli të mos mbështeste kauzën e UÇK-së, por e gjitha
24 kjo nuk ndryshon në asnjë mënyrë. Vëzhgimet, konstatimet e tij
25 në vend apo njohuritë për vendin.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 13

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 Një shembull tjetër është dëshmia e z. Fatmir Humolli.
2 Edhe ky një dëshmitar i ZPS-së që dëshmoi për fakte që binin
3 ndesh me akuzat. Pavarësisht se cili ishte mendimi i z.
4 Humolli në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës,
5 familja e tij, gruaja dhe fëmijët ishin në atë kompleks dhe ai
6 vetë ishte i pranishëm aty në disa raste. Edhe dëshmia e tij u
7 nda veçasi si e pabesueshme edhe e pambështetshme, sepse
8 thjesht ai tha që BIA nuk kishte mandat të arrestonte dhe të
9 ndalonte njerëz.

10 Në fakt, dëshmia e z. Humolli konfirmoi atë të Fatmir
11 Sopit dhe Sejdi Veselit. Mirëpo, në fjalën e Trupit Gjykues,
12 paragrafi 133 në aktgjykim thuhet:

13 "Dëshmia e tij kundërshtohet në masë të madhe nga dëshmi
14 të tjera që janë qartësisht konfirmuese që tregojnë se persona
15 u mbajtën të ndaluar...".

16 Kjo thjesht se ai dëshmoi për mandatin e BIA-s nuk do të
17 thotë se ka kontradikta në dëshminë e tij. Dëshmia e tij si
18 anëtar i stafit komandues të zonës operative të Llapit është
19 vetë në kundërshtim me dëshmi të tjera të ndryshme të
20 dëshmitarëve viktime.

21 Është e qartë nga aktgjykimi se në momentin kur
22 dëshmitari jep dëshmi gojore që është në kundërshtim me
23 akuzat, Trupi Gjykues i hetoi ato dëshmitarë dhe mendimet e
24 tyre kur jepnin dëshmi të tilla. Këta njerëz ishin të njohur
25 me atë vend. Mbrojtja parashtron se ky standard nuk u zbatua

1 në lidhje me dëshmitarë të cilët dëshmuan në favor të akuzave.

2 Në këto raste dëshmitë e tyre u çmuan si të besueshme dhe u
3 vlerësuan si të tilla.

4 Mbrojtja parashtron se në mënyrën sesi iu qas dëshmive,
5 Trupi Gjykues nuk zbatoi në mënyrë të drejtë dhe të barabartë
6 standardet, në veçanti kur jepeshin dëshmi që thjesht binin
7 ndesh me akuzat apo dëshmitë e atyre që unë i quaj viktima-
8 dëshmitarë.

9 Në të njëjtën mënyrë Trupi Gjykues nuk zbatoi në mënyrë
10 të barabartë dhe të drejtë standardet në lidhje me provat që
11 nuk përputheshin me faktet, qofshin ato për vendin apo për
12 njerëzit që ishin mbajtur dhe ishin keqtrajtuar në atë vend
13 atëherë dhe aty. Kur një gjykatë nuk i vlerëson provat në
14 mënyrë të barabartë kjo shkon në dëm të akuzuarit dhe një
15 qasje e tillë nuk mund të ketë për pasojë një aktgjykim të
16 plotfuqishëm.

17 Prandaj, qasja e jobarabartë, e padrejtë dhe e njëanshme
18 nuk mund të quhet e vlefshme dhe prandaj e zhvlerëson
19 aktgjykimin. Kur paraqiteshin prova që binin ndesh me akuzat,
20 ato Trupi Gjykues vetëm i krahasonte me dëshmi që ishin dhënë
21 në favor të akuzave. Kjo mungesë e balancës është aq e dukshme
22 kur bëhet krahasimi midis dëshmive të dëshmitarëve që i kanë
23 aprovuar apo kundërshtuar akuzat. Në paragrafin 119, 129 edhe
24 133 është shembull i qartë ku Trupi Gjykues thotë që provat që
25 janë në kundërshtim me akuzat janë ndër vete kundërshtuese.

1 Edhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë u vlerësuan si të
2 pasakta. Trupi Gjykues i çmoi ato si jo të besueshme, sepse
3 ishin në kundërshtim me dëshmitë e dy dëshmitarëve të tjerë.

4 Për më tepër, duhet të bëhet një nuancim në qoftë se këta
5 katër dëshmitarë dhanë dëshmi që do të vërtetonin akuzat.

6 Njëri i përshkroi qartë, përshkroi qartë një vendndodhje
7 tjetër, Dëshmitari 4669. Një tjetër foli për dy ndërtesa të
8 tjera apo ambiente të tjera ku ishte mbajtur.

9 Dhe këta dy dëshmitarë, e kam fjalën për Dëshmitarin 4669
10 dhe 3594, ata devijuan në rrëfimin e tyre, për sa i përket
11 përshkrimit të vendndodhjes dhe për mendimin e Mbrojtjes
12 dëshmitë e tyre nuk u vlerësuan siç duhet në lidhje me
13 vendndodhjen e qendrës së ndalimit.

14 Trupi Gjykues nuk vlerësoi çdo provë duke marrë parasysh
15 tërësinë e provave. Rregulla 139(2) e Rregullores së
16 Procedurës së Provës dikton që vlerësimi i provave duhet të
17 bëhet në atë mënyrë. Mirëpo, Trupi Gjykues vlerësoi vetëm një
18 pjesë të një dëshmie në mënyrë selektive dhe rrjedhimisht nuk
19 kreu vlerësim të plotë në bazë të tërësisë së provave. Trupi
20 Gjykues me këtë bëri gabim meqë nuk zbatoi standardin e duhur
21 të përcaktuar në rregullën 139.

22 Tani do të kaloj në një temë tjetër që është vendndodhja
23 se ku pretendohet se u mbajtën dhe u torturuan apo keqtrajtuat
24 viktimat. Këto janë pikat 2 dhe 2D dhe 2E deri në pikën 2H të
25 apelit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 16

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 Pika 2D ka të bëjë me vendin konkret ku pretendohet se
2 ndodhën krimet. Gjykatësi i Procedurës Paraprake, konfirmoi
3 aktakuzën me 5 tetor 2020. Mbrojtja në dosjen e apelit ka
4 paraqitur shembuj ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake
5 konfirmon akuzat në bazë të faktit që njerëzit u mbajtën dhe u
6 rrahën në një ndërtesë të vetme me një dhomë ku ata mbaheshin
7 dhe që ndodhej poshtë, si dhe në një dhomë mbi atë dhomë, në
8 katin e parë.

9 ZPS-ja në dosjen e vet të para-apelit paraqet gjithashtu
10 vetëm një ndërtesë. Mbrojtja i diskuton këto aspekte në
11 paragrafët 99 dhe 100 të versionit të korrigjuar të dosjes së
12 apelit.

13 Gjykimi filloi më 19 [sipas përkthimit] shtator 2021 me
14 një deklaratë hyrëse të ZPS-së. Edhe në atë deklaratë vri në
15 dukje vetëm një ndërtesë të vetme ku pretendonte se ishin
16 kryer krimet. Tani Mbrojtja do që të luajë një incizim të
17 fjalës hyrëse ku diskutohet pikërisht kjo. I kërkoj Sekretarit
18 që ta luajë këtë pjesë nga minuta 1:01:05 deri në 1:05:43.

19 [Luhet videoincizimi]

20 "Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Tani do t'ju kthehem
21 ndërtesave ku pretendohet se u kryen krimet e pretenduara. Nga
22 fotografitë e kompleksit bëhet fjalë për një numër grup të
23 vogël ndërtesash. Ky kompleks nuk ekziston më dhe prej tij ka
24 mbetur vetëm një ndërtesë e vogël.

25 "Më lejoni t'ju tregoj disa fotografi të tjera të këtij

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 17

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 kompleksi të bërë nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
2 në prill të vitit 2006. Shpresoj që këto do t'ju ndihmojnë për
3 të kuptuar më mirë përbërjen dhe organizimin e atij vendi.

4 "Do të filloj sërish me fotografinë e bërë nga ajri në
5 vitin 2006 që e përmenda dhe që e tregova pak më herët.

6 "Dhe do t'i tregoja Sekretares që të na tregonte
7 diapozitivin me numrin 14.

8 "Ndërtesa e rrethuar është ndërtesa, sikurse pretendon
9 Prokuroria, ku kanë ndodhur krime të cilat janë paraqitur në
10 aktakuzë.

11 "Ndërkohë shikojmë diapozitivin numër 15.

12 "Ky diapozitiv, të nderuar Gjykatës, përshkruan tri
13 ndërtesa në kompleksin e ndalimit në Zllash ku, sipas
14 parashtrimeve të Prokurorisë në prill të vitit 1999, një numër
15 shqiptarësh të Kosovës, të ndaluar, u mbajtën në mënyrë të
16 paligjshme dhe u keqtrajtuan. Shigjeta me ngjyrë të kaltër
17 tregon dhomat në katin e sipërm të përdorura nga pjesëtarët e
18 BIA-s si dhe nga vetë i akuzuara kur ata qëndronin në Zllash.
19 Shigjeta me ngjyrë të verdhë tregon një pjesë më të ulët të
20 poshtme të ndërtesës ku mbaheshin viktimat e ndaluara.

21 "Tani ta shikojmë diapozitivin tjetër me numrin 16.

22 "Ky diapozitiv tregon të njëjtën ndërtesë, por nga një
23 kënd tjetër. Ndërtesa në anën e djathtë të kësaj fotografie
24 është ndërtesa e cila është me interes për ne. Është shigjeta
25 me ngjyrë të kaltër që e tregon atë ndërtesë për të cilën do

1 të flasim më tepër detaje.

2 "Do t'i kërkoja Sekretares që të na vendosë diapozitivin
3 e radhës.

4 "Në këtë diapozitiv kemi pamje që përshkruan ndërtesën
5 kryesore ku pretendohet se të kenë ndodhur keqtrajtimi i disa
6 prej viktimave. Ata janë mbajtur në një bodrum ose ahur në
7 pjesën e poshtme të ndërtesës në anën e majtë nga dera me
8 shkallë të treguar me shigjetën me ngjyrë të verdhë në
9 fotografi dhe dërgoheshin me anë të shkallëve të brendshme në
10 një vend në katin e epërm ku ata merreshin në pyetje dhe
11 rriheshin. Dhe ky vend është shënuar me shigjetën me ngjyrë të
12 kaltër. I akuzuari vetë po ashtu ka dhënë një përkthim të
13 hollësishëm të kësaj ndërtese.

14 "Të nderuar Gjykatës, ju do të shikoni të njëjtën
15 ndërtesë edhe në fotografi që do të tregon nga Mbrojtja; njëra
16 prej këtyre fotove do të jetë fotografia që do t'ju tregojmë
17 tani në diapozitivin 18. Ky është diapozitivi për të cilin e
18 kam fjalën.

19 "Në këtë diapozitiv ndërtesa është në anën e majtë të
20 fotografisë, shigjetat me ngjyrë të kaltër dhe të verdhë
21 tregojë përkatësisht vendin e përdorur nga BIA gjatë marrjes
22 në pyetje dhe keqtrajtimit të viktimave dhe vendin ku
23 mbaheshin viktimat që është pjesa e ndërtesës që tregohet me
24 shigjetë të verdhë.

25 "Ndërtesa më e vogël aty ngjitur, një ahur prej druri, me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 19

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 një dhomë trekëndore të mbuluar me tjegulla të kuqe është e
2 vetmja ndërtesë e cila ka mbetur në terren dhe që është ende
3 aty dhe sot e kësaj dite".

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, Sekretar.

5 "Ndërtesa e rrethuar" -- do të bëj tre citime.

6 "Ndërtesa e rrethuar, diapozitivi 14 është njëra ku sipas
7 Prokurorisë ndodhen krimet e paraqitura në aktakuzë".

8 Dhe;

9 "Ndërtesa në diapozitivin 16, në anën e djathtë të kësaj
10 fotografie është ajo që na intereson në këtë çështje gjyqësore
11 dhe shigjeta e kaltër e tregon këtë ndërtesë".

12 Dhe citimi i fundit:

13 "Diapozitivi 17 paraqet ndërtesën kryesore ku pretendohet
14 se u kryhen keqtrajtmet e disa viktimave".

15 Aktakuza bazohej në këtë ndërtesë të vetme që tregoi ZPS-
16 ja. Ndërtesa, gjithashtu, u përmend edhe si oda. Dëshmitarët
17 merreshin në pyetje gjatë dëshmive të tyre dhe atyre iu
18 treguan këto fotografi. Mbrojtja, në hetimet e veta,
19 gjithashtu u përqendrua në të njëjta ndërtesa dhe më pas
20 dëshmitarët u morën në pyetje në lidhje me këtë ndërtesë të
21 vetme.

22 Sido që të jetë, vendi dhe veprimet janë elemente
23 kryesore që duhet të përcaktohen në mënyrë që të nxirret një
24 vendim fajësie apo pafajësie. Në Gjykatën Penale Ndërkombëtare
25 "Elementet e krimeve" në lidhje me ndalimin e paligjshëm janë

1 përcaktuar qartë dhe kjo është në statutin e GJPN-së, neni
2 8(2) (a) (vii). Edhe pse nuk bëhet fjalë për të njëjtën krim,
3 mirëpo, është indikativ.

4 Mbrojtja parashtron se as ZPS-ja dhe as Trupi Gjykses nuk
5 mund të devijojnë nga disa vende kur ai vend është përmendur
6 në mënyrë të vazhdueshme dhe konkrete nga ZPS-ja.

7 Dhe ZPS-ja nuk mund të ndryshojë pozitën e vet në lidhje
8 me këtë vend. Ajo duhet ta kishte ndryshuar aktakuzën. Trupi
9 Gjykses i kërkoi sqarim ZPS-së në lidhje me këtë. Sikurse e
10 parashtron Mbrojtja në dosjen e apelit në paragrafin 103 deri
11 në 108, pikërisht këtë e bëri ZPS-ja. Mbrojtja parashtron se
12 ndryshimi i vendndodhjes ku është kryer krimi i pretenduar i
13 ndalimit arbitrar dhe i torturës e vendos Mbrojtjen në një
14 pozitë mjaft të palakmueshme.

15 Në fakt Mbrojtja parashtron se vendi disi nuk ka qenë i
16 qartë, vendi ku ka ndodhur krimet e pretenduara. Sikur
17 Mbrojtja ta kishte ditur që nga fillimi këtë vend, sikurse më
18 vonë që parashtron ZPS-ja dhe jo të përqendrohej vetëm në një
19 ndërtesë të vetme, atëherë do t'i kishte marrë në pyetje
20 dëshmitarët e Prokurorisë në mënyrë tjetër. Dhe dëshmitarët
21 mund të kishin thënë atëherë diçka më shumë në lidhje me
22 përdorimin e atyre apo funksionin e atyre ndërtesave.

23 Mirëpo, nuk ishte nevojë që të bëhej kjo, sepse ky vend
24 që është thënë çdoherë ka qenë vetëm një vend dhe përshkrimi
25 që e ka bërë ZPS-ja ka qenë i qartë edhe për Gjykatësin e

1 Procedurës Paraprake. Çdo dëshmitar ka folur për pjesën poshtë
2 dhe të sipërme të një ndërtese të cilat kanë qenë, e cila ka
3 qenë pjesë e një kompleksi me më shumë ndërtesa.

4 Trupi Gjykses në aktgjykimin e vet, në paragrafin 372
5 deklaroi se kjo çështje nuk është materiale për përcaktimin e
6 akuzave. Atëherë pse Trupi Gjykses i kërkoi ZPS-së gjatë
7 gjykimit në një pyetje konkrete para argumenteve se në cilën
8 ndërtesë konkretisht ishin kryer krimet sipas ZPS-së. Mbrojtja
9 parashtron se Trupi Gjykses bëri gabim, sepse është e
10 rëndësisë thelbësore që të përcaktohet vendi i saktë ku
11 pretendohet se janë kryer krimet.

12 Aktakuza bazohet në fakte. ZPS-ja i nxjerr akuzat në bazë
13 të fakteve, ashtu sikurse i prezantohen asaj. Këto fakte janë
14 të rëndësisë thelbësore për një çështje gjyqësore dhe
15 sigurisht që kanë mangësi materiale për akuzat. Baza e çdo
16 akuze janë faktet. Dhe në këtë rast, Trupi Gjykses detyrohej
17 që të nisej nga faktet mbi të cilat bazoheshin aktakuzat. ZPS-
18 ja nuk mund thjesht t'i indryshojë ato fakte për t'ia
19 përshtatur nevojave të veta. Mbrojtja dhe i akuzuari duhet të
20 jenë në gjendje që të bazohen në fjalën e ZPS-së kur ajo
21 paraqet provat e veta.

22 Trupi Gjykses gabon kur thotë që kjo çështje nuk është
23 materiale për përcaktimin e akuzave. Faktet janë vetë baza e
24 çdo akuze.

25 Trupi Gjykses gjithashtu gaboi në paragrafin 373 të

1 aktgjykimit kur përfundoi se Mbrojtja kishte mundësi të
2 bollshme për t'i marrë në pyetje dëshmitarët e ZPS-së në
3 lidhje me këtë çështje. Jo, Mbrojtja nuk e pat këtë mundësi,
4 sepse fakti i vendndodhjes së krimeve doli në pah dikun nga
5 fundi i gjykimit.

6 Është e detyrë e Trupit Gjykues që të përcaktojë të
7 vërtetën dhe në këtë drejtim Mbrojtja parashtron se gjykimi
8 nuk u fokusua në asnjë ndërtesë tjetër përveç asaj që e dha
9 ZPS-ja.

10 Mbrojtja riafirmon edhe një herë qëndrimin e vet sepse ky
11 është një devijim thelbësor nga vendndodhja e pretenduar e
12 krimit është e padrejtë dhe përbën gabim gjyqësor.

13 Është e rëndësisë fundamentale dhe e drejtë themelore e
14 të akuzuarit që të dijë vendin e saktë se ku pretendohet të
15 jenë kryer krimet. Po e përdori fjalën "ku", jo në kuptim të
16 Zllashit apo të kompleksit, por në kuptim të ndërtesës
17 specifike që ka bërë të ditur ZPS-ja në deklaratën hyrëse të
18 vet dhe në fotografitë që i tregoi dëshmitarëve. Mbrojtja dhe
19 Trupi Gjykues duhet të kenë mundësinë që të mund të mbështeten
20 në informata të tilla specifike.

21 Mbrojtja, edhe një herë, thekson se kjo nuk iu tregua në
22 kohë. Të gjithë dëshmitarët nuk kishin një pamje të qartë dhe
23 nuk mund në mënyrë të arsyeshme të kishin identifikuar
24 ndërtesën.

25 Trupi Gjykues dhe po citoj paragrafin 272 të aktgjykimit

1 thotë:

2 "Trupi Gjykues duhet të bindet se krimi ka ndodhur në një
3 apo më shumë ndërtesa të identifikuara më lart në bazën e BIA-
4 s midis datës 1 dhe 19 prill..."

5 Faktori kryesor këtu është se ndërtesa u identifikua dhe
6 posa pamë një diapozitiv për këtë ndërtesë dhe sikurse thashë
7 edhe më herët dhe gjatë gjithë gjykimit vetëm kjo ndërtesë e
8 vetme u identifikua.

9 Paneli nuk mund të devijojë nga aktakuza. Aktakuza
10 propozohet, ngrihet nga ZPS-ja dhe konfirmohet nga Gjykatësi i
11 Procedurës Paraprake. Prandaj, nuk ka hapësirë për interpretim
12 tjetër nga ana e Trupit Gjykues. Dhe Trupi Gjykues gaboi sepse
13 duke kryer gjykimin në këtë mënyrë, ajo parashtron, Trupi
14 Gjykues parashtron standardet e veta, duke anashkaluar në këtë
15 mënyrë interesat e Mbrojtjes.

16 Këto interesa të justifikuara janë, ndërmjet të tjerash,
17 që Mbrojtja duhet të ketë mundësi që me siguri të mbështetet
18 në gjërat konkrete të çështjesh ashtu siç është parashtruar
19 çështja nga ZPS-ja dhe në aktakuzën e konfirmuar. Marrja në
20 pyetje e të gjithë dëshmitarëve përkatës për të gjitha akuzat
21 nga Mbrojtja, duke marrë parasysh të gjitha ndërtesat e tjera
22 që mund të kenë qenë në kompleks, duhet të ishte dhënë
23 informacion paraprak Mbrojtjes për këtë gjë dhe duhet të ishte
24 marrë parasysh në kohën e përgjithshme që është dhënë
25 Mbrojtjes, 50 për qind të kohës së ZPS-së. Në këtë fazë të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 24

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 procesit gjyqësor kur ka ndodhur kjo kohë se Trupi Gjykses ka
2 bërë këto pyetje përpara sesa të bëheshin parashtrimet e
3 argumenteve me gojë përfundimtare. Ndërkohë një tjetër element
4 i rëndësishëm janë hetimet që Mbrojtja duhej të kishte
5 ndërmarë, duke marrë parasysh vendin dhe përzgjedhjen e
6 dëshmitarëve dhe dëshmitë që kanë të bëjnë me ndërtesën e
7 këtij kompleksi.

8 Fakti që ZPS-ja në deklaratën hapëse ka identifikuar
9 vetëm një vend të vetëm që duhet që të merret parasysh, sepse
10 në të kundërtën kemi të bëjmë me gabim gjyqësor dhe kjo është
11 një ndryshim fakti, ndryshim faktik i cili ka ndryshuar drejt
12 fundit -- të gjykimit. Ndërkohë baza faktike duhej të ishte
13 caktuar që në fillim fare të procesit gjyqësor qartësisht dhe
14 duhet t'i kishte dhënë të gjithë hapësirën e nevojshme
15 Mbrojtjes, në kuptimin që Mbrojtja duhet të kishte bërë punën
16 e vet nga kjo bazë faktike.

17 Kjo siguri jepet në aktakuzën e konfirmuar si dhe në
18 parashtrimin e rrethanave faktike nga ZPS-ja sa i takon
19 fakteve të pretenduara.

20 Tani në qoftë se një palë ndryshon bazën faktike ose
21 fillon që ta ndryshojë bazën faktike, atëherë Mbrojtja nuk
22 mund ta parashikojë një gjë të tillë dhe sigurisht që nuk mund
23 të parashikojë që kjo gjë të ndodhë, aq më tepër kur kjo gjë
24 parashtrohet nga fundi i fazës së gjykimit të çështjes.

25 Mbrojtja duhet të ketë mundësi që të mbështetet me siguri

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 25

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 që ekspozēja faktike e dhënë nga ZPS-ja dhe që baza faktike
2 siç paraqitet në aktakuzën e konfirmuar do të jetë dhe do të
3 mbesin baza faktike deri në fund të procesit gjyqësor. Dikush,
4 askush nuk mund ta ndryshojë këtë bazë faktike ose ta
5 ndryshojë atë në mënyrë të tillë që t'i shërbejë çështjes së
6 provave të veta. Palët duhet t'i shërbejnë drejtësisë dhe jo
7 çështjes së tyre. Megjithatë, fatkeqësisht, kjo është ajo
8 çfarë ka bërë ekzaktësisht ZPS-ja.

9 Gabimi në konsiderimin e Trupit Gjykues që kjo nuk ka
10 rëndësi materiale për përcaktimin e akuzave është i gabuar dhe
11 rezulton në një gabim gjyqësor. Trupi Gjykues duhet të kishte
12 qenë kritik ndaj këtyre akuzave faktike. Në vend të kësaj,
13 Trupi Gjykues vendosi që ato nuk kanë rëndësi materiale për
14 akuzat. Për Trupin gjykues, por edhe për Mbrojtjen të dyja
15 këto palë, pra, duan që të mbështeten në bazën faktike të
16 paraqitur nga ZPS-ja. Kjo duhet të bëhet, sepse në fakt ky
17 përbën pikën nistore lidhur me vlerësimin, me pyetjet e bëra,
18 vendet, faktet dhe elementë të tjerë që kanë të bëjnë me
19 akuzat në aktakuzë. Për shkak të faktit që vendi ose pyetje
20 "Ku", është një element shumë i rëndësishëm; po aq i
21 rëndësishëm sa edhe pyetja "Çfarë", domethënë: Çfarë ka
22 ndodhur në këtë vend? Dhe pyetja "Kur": Kur kanë ndodhur
23 ngjarjet e pretenduara? Këto janë të gjithë elementë të
24 aktakuzës që janë kritike për të përcaktuar në mënyrë të tillë
25 që të shpallet një i akuzuar fajtor për një akuzë të caktuar.

1 E gjithë kjo e marrë në tërësinë e vet pa diskutim që çon
2 në gabim gjyqësor që rezulton nga baza e gabuar faktike e
3 çështjes. Trupi Gjykses mund të mos ndryshojë ose të
4 interpretojë aktakuzën ose të mos plotësojë mangësitë në
5 aktakuzë në mënyrë që ato të mund të përkojë me akuzat. Ajo
6 gjithmonë do të sigurojë që i akuzuari të përfitojë nga një
7 dyshim i tillë. Trupi Gjykses mbështetur në konkluzionet e
8 veta për fajësinë, këtë përfundim për fajësinë e të akuzuarit
9 e ka mbështetur në bazën faktike të gabuar dhe si rezultat nuk
10 ka arritur në një përfundim korrekt.

11 Pika 2E dhe Pika 2H janë shumë të lidhura ngushtë me
12 temën që unë sapo diskutova. Mbrojtja, sa i takon Pikës 2E
13 parashtron që dëshmitarët nuk ishin në një pozitë që të
14 identifikonin ndërtesën ku ishin mbajtur për shkak të
15 rrethanave dhe kohës së arrestimit tyre edhe për shkak të
16 lëvizjes së tyre.

17 ZPS-ja kishte, parashtroi, katër dëshmitarë që thanë që
18 ishin ndaluar. Njëri prej tyre, Dëshmitari 03594 dëshmoi se
19 nuk e ka parë asnjëherë të akuzuarin në vendin ku është
20 ndaluar apo ku është marrë në pyetje. Megjithatë, në
21 paragrafin 364 të Aktgjykimit, Trupi Gjykses arriti në
22 përfundimin që "ata mund të kishin identifikuar ndërtesat ku
23 pretendohet se janë ndaluar". Kjo është mbështetur në tregimin
24 e dëshmitarëve të të njëjtave fotografive që ata kishin parë
25 edhe më herët dhe që kishin konfirmuar këtë gjë në një seancë

1 të mbyllur.

2 Ky përfundim që ka të bëjë me identifikimin është i
3 gabuar pasi asnjë tribunal i arsyeshëm nuk do të kishte
4 mbërritur në këtë përfundim. Trupi Gjykues nuk do të mund të
5 arrinte një përfundim të tillë në mënyrë të arsyeshme. Arsyeja
6 është se të tre dëshmitarët kanë dëshmuar lidhur me rrethanat
7 në të cilët janë arrestuar dhe transportuar kur janë marrë në
8 pyetje. Dhe ku duhej që të merreshin në pyetje edhe ata thanë
9 që kishin pasur një thes të vënë në kokë. Konstatimet e Trupit
10 Gjykues se këta tre persona kanë pasur mundësi të
11 identifikojnë vendin e ndalimit të tyre nuk pajtohet me faktet
12 e dëshmuara nga këta tre dëshmitarë. Në paragrafët 675 të
13 Trupit Gjykues, Trupi Gjykues verën si më poshtë:

14 "Kjo atmosferë e frikës së vazhdueshme është nxitur më
15 tej nga fakti që të ndaluarit nuk janë informuar për arsye e
16 mohimit të lirisë që atyre ju ishin vendosur thasë në kokë dhe
17 që atyre, pra, këto thashë që iu ishin vendosur në kokë.
18 Ndërkohë që kanë dalë apo janë dërguar në ahur dhe ata kanë
19 ecur në errësirë; nuk janë lejuar që të flasim me njëri-
20 tjetrin dhe nuk janë lejuar që flenë".

21 Mbrojtja parashtron se këto dy aspekte bien ndesh me
22 njëra tjetrën deri në masën që ato nuk mund të jenë në
23 përputhshmëri. Nuk mund të jenë të dyja njësoj të vlefshme.
24 Nuk mund të nxjerrë asnjë përfundim për identifikimin pozitiv
25 kur dëshmi të tilla janë kaq shumë konfliktuale. Rreth një

1 rrethanë në mënyrë të domosdoshme përjashton tjetrën.

2 Trupi Gjykses nuk ka përcaktuar asnjë standard mbështetur
3 në të cilin mund të bëhej identifikimi i besueshëm i vendit të
4 ndalimit nga asnjë nga dëshmitarët. Kështu që në kohën shumë
5 të shkurtër të lirimit të tyre nuk është e besueshme, edhe një
6 herë, nuk është e besueshme dhe aq e mbështetshme që t'i jepet
7 besim dhe të vishen me vlerë dëshmitë e tyre sa i takon kësaj
8 çështjeje.

9 Ne kemi parashtruar dhe jemi referuar tre dëshmitarëve në
10 dosjen tonë të apelit dhe këto dëshmitarë janë 1679, 3593 dhe
11 4669. Këtë e kemi bërë në paragrafët nga 115 deri 150 të
12 dosjes së apelit. Identifikimi i vendit prej tyre, duke marrë
13 parasysh rrethanat siç ato parashtrohen në dosjen e apelit
14 janë tërësisht, do ta përsëris edhe një herë. Pra,
15 identifikimi i vendit prej tyre, duke marrë rrethanat e tyre,
16 siç ato janë parashtruar në dosjen e apelit, nuk ka të ngjarë
17 që të jenë të vërteta, sepse sa herë që kanë dalë jashtë
18 godinës, atyre iu ishte vënë një thes në kokë. Kështu që me
19 fjalë të tjera kjo nuk është identifikim përkatës. Sa i takon
20 njërit prej tyre godina ose ndërtesa në fotografi ishte
21 thjesht një ndërtesë që i ngjante ndërtesës që ai kishte në
22 mendje.

23 Mbrojtja parashtron se këto fakte të çështjes janë të
24 gabuara edhe ne parashtrojmë që nuk standard të arsyeshëm
25 përcaktuar nga Trupi Gjykses mbi të cilin mund të ishte bërë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 29

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 një identifikim pozitiv i ndërtesës. 22 vite pas fakteve të
2 thuash që dëshmitarët kanë identifikuar ndërtesën, ndërtesat
3 dhe të mos marrësh parasysh atë çfarë kanë thënë dëshmitarët
4 lidhur me ndalimin e tyre dhe transportimin në vendin e
5 ndalimit padyshim që bie ndesh me një identifikim të tillë.
6 Kështu që si rezultat kemi të bëjnë me një identifikim jo të
7 përshtatshëm dhe për pasojë në një përfundim të gabuar.

8 Së fundi --

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Ju kërkoj
10 ndjesë Avokat. Kemi një pyetje.

11 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund
12 t'ju bëj një pyetje. Dua që t'i them ndërtesave; e kam fjalën
13 konkretisht për paragrafin 372 të Aktgjykimit ku Trupi Gjykses
14 i referohet ose përmend shumë ndërtesa.

15 Në aktakuzë janë paragrafët 5, 18, 31, 32 dhe 35 ku ZPS-
16 ja parashtron dhe citoj këtu:

17 "Njësia BIA ka operuar nga një kompleks i cili përbëhet
18 nga disa ndërtesa dhe që njësia BIA e ka përdorur kompleksin
19 si shtëpi të sigurt dhe si një vend për të marrë në pyetje dhe
20 të ndërtuar".

21 Këtu flitet për një kompleks; nuk flitet për një
22 ndërtesë, a është e vërtetë kjo apo jo?

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sigurisht që
24 kompleksi përbëhet nga disa ndërtesa dhe këtë në fakt e vumë
25 re dhe nga parashtrimet e seancës së hapjes së çështjes nga

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 30

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 ZPS-ja. Kompleksi përbëhet nga disa ndërtesa, por nuk është
2 kjo çështja. Çështja është se në cilin vend konkret janë
3 mbajtur të ndaluar këta persona. Ku janë torturuar apo
4 keqtrajtuar këta persona apo ku janë lënë vetëm ata, çfarë,
5 domethënë kjo është çështja që ngre unë. Ky është elementi që
6 ka qenë subjekti i marrjes në pyetje të dëshmitarëve nga ZPS-
7 ja, nga Mbrojtja dhe nga Trupi Gjykses. Dhe prandaj unë
8 transmetova dhe kërkova transmetimin e videos së parashtrimit
9 fillestar të ZPS-së.

10 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Ky është devijimi këtu në
11 qoftë se aktakuza flet për kompleksin dhe Trupi Gjykses flet
12 dhe këtu citoj, domethënë, ai -- është ky citimi që ka të bëjë
13 me rëndësinë jomateriale:

14 "Krimet e pranishme në aktakuzë ndodhën një ose disa
15 ndërtesa të identifikuara më sipër, përfshirë këtu dhe
16 ndërtesën precize".

17 Do ju kërkoja të më thoni se cili argumenti ligjor, pse
18 mendoni që ky konstatim i Trupit Gjykses është i gabuar ose i
19 paligjshëm, sepse ja u thashë citimin e Trupit Gjykses më
20 parë. Pamë gjithashtu edhe videon por nga ana tjetër aktakuza
21 në vetvete nuk është se flet vetëm për një ndërtesë, por flet
22 për disa ndërtesa. Dhe Trupi Gjykses e parashtron, e reflekton
23 këtë gjë. Dua t'ju pyes në qoftë se keni ndonjë problem me
24 përfundimin e, konkluzionin e Trupit Gjykses në paragrafin
25 372?

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, kam një problem me këtë
2 çështje, sepse është e vërtetë që kompleksi përbëhet nga shumë
3 ndërtesa. Për këtë biem dakord të gjithë. Por ku në këtë
4 kompleks mendohet që njerëzit janë mbajtur dhe janë
5 keqtrajtuar. Në çfarë vendi në këtë kompleks. Domethënë ky
6 duhet të jetë fokusi i hetimeve të ZPS-së, por është pjesë
7 gjithashtu edhe e Aktakuzës së Konfirmuar. Domethënë, në
8 Aktakuzën e Konfirmuar thuhet shprehimisht, thuhet saktësisht
9 se ku pretendohet që të jenë mbajtur të ndaluar dhe janë
10 torturuar këta persona.

11 Dhe nuk mund të thuhet drejt fundit të gjykimit që
12 personat janë mbajtur në ndërtesa të ndryshme. Ndërtesa në
13 vetvete është identifikuar me qartësi nga Prokuroria. Kështu
14 që për këtë arsye Mbrojtja parashtron se përderisa flitet për
15 këtë ndërtesë, neve themi që Prokuroria, por gjithashtu edhe
16 Aktakuza e Konfirmuar flet konkretisht për vendin ku janë
17 mbajtur njerëzit. Domethënë që janë mbajtur në katin përdhe,
18 janë marrë në pyetje në katin e parë. Kështu që ne themi që
19 kjo nuk është se nuk ka rëndësi materiale për akuza, siç thotë
20 Trupi Gjykses. Ne parashtrojmë të kundërtën, sepse këto akuza
21 mbështetet te faktet, dhe faktet janë këto që unë sapo
22 përmenda. Pra, fakti që bëhet fjalë për një ndërtesë të vetme
23 që ka interes të posaçëm nga ZPS-ja që ne e treguam edhe
24 përmes videos së sapo luajtëm.

25 Pra, edhe një herë tjetër, përpara parashtrimit me gojë u

1 bë pyetja nga Trupi Gjykses dhe se ZPS-ja dha përgjigjen e
2 vet. Edhe aty pastaj i vuri gishtin ose përmendi disa
3 ndërtesa. Shpresoj që është e qartë se çfarë pozicioni ka
4 Mbrojtja lidhur me këtë çështje, të nderuar Gjykatës.

5 Së fundi, të nderuar Gjykatës, është me rëndësi në qoftë
6 se tre dëshmitarët kanë implikuar apo jo të akuzuarin.

7 Dëshmitari 1679 nuk e njihte fare të akuzuarin, por 22
8 vite pas ngjarjeve ai identifikoi ndërtesën, ndërtesat apo
9 personin. Nuk mund të mbështetesh në identifikimin e të
10 akuzuarit vetëm nga fakti që dëshmitari thotë që nuk e ka
11 njohur fare të akuzuarit më përpara. Gjatë gjithë periudhës së
12 ndalimit dhe keqtrajtimit të tij, ai asnjëherë nuk ka
13 identifikuar as personin, kryesin e veprës edhe as vendin.

14 Ndërkohë Dëshmitari 3593 beson se bëhej fjalë për të
15 akuzuarin. Ne i kemi bërë këtë pyetje herë pas here.
16 Megjithatë, ai thotë që beson, dhe do t'jua citoj paragrafin
17 përkatës pas një çasti, ai thotë që beson që i akuzuari është
18 personi që e ka marrë në pyetje atë. Kjo pasqyrohet në
19 paragrafin 69 të aktgjykimit.

20 Domethënë "të besosh", çfarëdolloj gjëje të mund të
21 thotë; çfarë lloj-lloj kuptimi mund të ketë kjo shprehja nuk
22 mund të çojë në identifikimi e saktë të të akuzuarit. Sipas
23 fjalëve të Trupit Gjykses, ai thotë që ai beson që personi
24 ishte i akuzuar, duke marrë parasysh atë çfarë mbante në kokë
25 ai, çfarë autoriteti dhe çfarë roli kishte me kryesit e tjerë

1 dhe nofkës që i drejtoheshin të tjerët. Ai tha se këtë, që ai
2 kishte mësuar që komandanti në Zllash ishte i akuzuari dhe
3 këtë e kishte marrë vesh nga persona të tjerë. Kjo jepet në
4 paragrafin 70 të aktgjykimit.

5 Edhe nëse ky person nuk ka pasur mundësi që të përcaktojë
6 dhe të identifikojë vendin siç duhet, dhe kjo jepet në
7 poshtëshënimin 739, sikurse është parashkruar nga Mbrojtja në
8 paragrafin 121 të mëtejshme të dosjes së apelit, ai nuk e ka
9 identifikuar asnjëherë as të akuzuarin.

10 Për sa i takon pikave të apelit numër 2, ne kemi listuar
11 faktet që ne parashtrojmë që janë përcaktuar me gabim ose që
12 asnjë gjykatë e arsyeshme nuk do të kishte arritur në
13 përfundimin që ka arritur Trupi Gjykses.

14 Për pasojë kur faktet e çështjes përcaktohen me gabim
15 Trupi Gjykses ka çuar në nxjerrjen e përfundimeve të gabuara
16 dhe ka konstatuar që i akuzuari është fajtor për pikat 1 dhe 3
17 që është ndalimi arbitrar dhe tortura.

18 Themeli i akuzave janë vetë faktet dhe kur faktet
19 përcaktohen me gabime dhe jo në mënyrë të saktë, kjo përbën
20 gabim gjyqësor. Kur ka një vlerësim të gabuar të fakteve dhe
21 kur nxirret një përfundim i gabuar mbi bazën e konstatimeve të
22 fajësisë dhe pafajësisë për të akuzuarin. Një konstatim i
23 tillë fajësie për të akuzuarin në rastin në fjalë nuk mund të
24 mbështetet në arsye të tilla. Dhe kjo është gabim gjyqësor.
25 Një konstatim fajësie nuk mund të mbështetet tek dëshmia e

1 dikujt që thotë se beson se e ka identifikuar të akuzuarin si
2 personin që e ka keqtrajtuar apo e ka torturuar apo ndaluar
3 atë.

4 Tani dua të kaloj te Pika 2G dhe 2I.

5 Pika 2G ka të bëjë me faktin që Trupi Gjykues nuk i ka
6 dhënë peshë të përshtatshme dëshmitarëve të Mbrojtjes që kanë
7 pasur mundësi që të shohin vendin. Kjo parashtrohet në
8 paragrafin 158 deri 178 që kemi diskutuar edhe në dosjen tonë
9 të apelit.

10 2I-ja ka të bëjë me faktin që Trupi Gjykues në mënyrë të
11 vazhdueshme konsideron sinjale, deklaratat ose prezumon që
12 dëshmitarët do të kenë tendencë për të dhënë dëshmi të
13 favorshme për të akuzuarit dhe jo të favorshme për ZPS-në.

14 Çështja këtu, apo të dyja çështjet këtu janë të
15 ndërlydhura me njëra-tjetrën. Dikush që vjen dhe jep dëshmi
16 nën betim dhe secili prej dëshmitarëve që ka ardhur këtu
17 përpara Trupit Gjykues ka dhënë betimin, ka bërë betimin. Ne
18 jemi përqendruar tek standardi i vlerësimit të dëshmitarëve.
19 Ndërkohë që standardi nuk është zbatuar në mënyrë të plotë apo
20 siç duhet kur dëshmitarët janë vlerësuar për besueshmërinë ose
21 mbështetshmërinë e tyre.

22 Në total kemi tetë dëshmitarë të Mbrojtjes të cilët kanë
23 qenë në kompleks në kohën përkatëse: Mehmeti, Sopi, Veseli,
24 Ajeti, Krasniqi, Hadri dhe Ibadete Kaçiu-Canolli. Të gjithë
25 këta mohojnë se ka pasur ndonjë vend në kompleks ku njerëzit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 35

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 janë mbajtur, janë ndaluar apo janë keqtrajtuar.

2 Dhe ne nuk flasim për ndonjë kompleks shumë të madh.

3 Sipërfaqja këtu është e ngjashme me gjysmën e një fushe

4 futbollli. Domethënë është një sipërfaqe goxha e kufizuar në

5 këtë rast.

6 Asnjëri prej tyre tetë dëshmitarëve të Mbrojtjes nuk

7 kishte probleme me të parit. Ata folën qartësisht për

8 mospraninë, pra, për mosekzistencën të ndonjë vendndalimi aty

9 dhe në atë kohë, periudhë kohore. Dëshmia e tyre u refuzua, u

10 hodh poshtë sistematikisht.

11 Kur një person dëshmon, të nderuar Gjykatës, ai mund të

12 ketë fotografinë në llogarinë e tij në Facebook ose mund të

13 ketë respekt për dikë. Këto lloj çështjesh duhet të ndahen, të

14 veçohen nga ajo që ata kanë përjetuar në të vërtetë, kanë

15 parë, kanë konstatuar, vërejtur në kohën dhe që mbulohet nga

16 periudha e aktakuzës. Fjala "dëshmitar" ka një kuptim, sheh,

17 dëgjon apo ka një përvojë. Kaq, këtë kuptim ka fjala

18 "dëshmitar".

19 Interesat e tyre personale nuk bëjnë ndonjë dallim

20 domosdoshmërisht lidhur me atë që këta dëshmitarë kanë

21 përjetuar apo dëshmuar. Megjithatë, Trupi Gjykses në mënyrë

22 arbitrare, në mënyrë sistematike vlerësoi dëshminë e tyre ose

23 të pabesueshme ose të pambështetshme dhe në disa raste të

24 dyja.

25 Trupi Gjykses e shohin faktorët e rëndësishëm në

1 vlerësimin e tyre për këta dëshmitarë. Dëshmitarët -- Mbrojtja
2 e vlerëson të gabuar që të vlerësohet dëshmia si e pabazë dhe
3 e pabesueshme, thjesht duke kundërvënë ndaj kësaj dëshmi të
4 dhëna nga dëshmi të tjerë, dëshmitarë të tjerë. Për shembull,
5 kemi dikë që ka thënë që është mbajtur i ndaluar dhe në një
6 rast tjetër thotë që në vendin ku ka qenë nuk ka patur
7 vendndalim. Trupi Gjykues në shumë raste, në paragrafin 367 të
8 aktgjykimit dëshmitë që mohojnë, kërkoj ndjesë, dëshmi që
9 mohojnë pretendimet e bëra nga dëshmitarë që kanë marrë --
10 qenë të pranishëm në krim nuk është bindëse e krahasuar me
11 dëshminë e pranuar nga dëshmitarë-viktima.

12 Mund të jetë që dëshmitarët që kanë dëshmuar për
13 mospraninë e ndonjë personi të ndaluar në kompleks është e
14 vërtetë. Mund të jetë rrjedhimisht që ka patur të ndaluar në
15 diku, në një vend tjetër. Kjo sigurisht nuk do të thotë që
16 dëshmia është e pabazë, thjesht sepse kjo -- është në
17 kundërthënie me dëshmi të tjera të dhëna.

18 Mbrojtja pohon se Trupi Gjykues në fakt nuk i ka
19 vlerësuar në mënyrë të kujdesshme vëzhgimet e këtyre
20 dëshmitarëve. Në vend të kësaj është përqendruar në një lloj
21 lidhje mes të akuzu -- dëshmitarit dhe të dëshmitarëve dhe të
22 akuzuarit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] A mund t'ju
24 ndërpres për një çast?

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 37

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Ne në
2 urdhrin tim, duke patur parasysh këtë seancë kemi bërë disa
3 pyetje, një sërë pyetjesh. A do t'ju përgjigjeni atyre
4 pyetjeve, sepse keni bërë tashmë një orë që keni fjalën, a
5 mund t'ju kërkojnë t'u përgjigjeni pyetjeve?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Pyetjeve të Gjykatës?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Po.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Dëshironi që ta bëj tani, sepse
9 kam një rend të paraparë dhe ka kuptim që ta bëjmë më vonë
10 këtë gjë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Keni pak më
12 shumë se gjysmë orë, që, s'ju ka ngel më shumë.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Jam, në qoftë se më lejoni duhet
14 të trajtoj pyetjet tuaja në një fazë të mëvonshme. Po.

15 Mbrojtja pohon se Trupi Gjykses nuk i ka vlerësuar në
16 mënyrë të kujdesshme vërejtjet dhe vëzhgimet e dëshmitarëve,
17 për të cilët kanë dëshmuar dhe u përqendrua në një lloj lidhje
18 mes dëshmitarit dhe të akuzuarit dhe ka përdorur këtë sikurse
19 tregimi i dëshmitarëve nuk ishte i besueshëm apo i
20 mbështetshëm. Mbrojtja ka dhënë shembuj të shumtë në dosjen e
21 apelit dhe besojmë se është e pavend të krijohet një lidhje
22 mes, në njërin anë, vëzhgimet e thjeshta të një dëshmitari,
23 dhe në anën tjetër, qëndrimin e tij, pozicionin e tij në
24 periudhën e konfliktit.

25 Në qoftë se nuk besojmë atë që ushtarët e UÇK-së apo

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 38

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 vullnetarët në konflikt kanë, thonë, thjesht sepse në një
2 moment të caktuar ata kanë në kontakt me të akuzuarin, atëherë
3 nuk ka kuptim që t'i marrim fare, që të japin dëshmi. Fatmir
4 Sopi ka qenë komandant brigade dhe në qoftë se ai thotë që ka
5 qenë aty dhe që nuk ka patur ndalim në kompleks pse nuk është
6 i besueshëm ky?

7 Në qoftë se dëshmitar tjetër bën, poston diçka në
8 llogarinë e tij Facebook lidhur me faktin që ka qenë krenar që
9 ka qenë ushtar i ri, dhe ka konstatuar që ka, ai ishte
10 komandant i mirë dhe nuk ka patur arsye që ta përdorë këtë në
11 dëm të të akuzuarit. Z. Ajeti që është një, tha biles se ai
12 vetë ka transportuar me duart e tij persona të plagosur në
13 ndërtesën në odë pra, dhe ka mohuar që në ndërtesë ka patur
14 njerëz që ishin të ndaluar apo të keqtrajtuar. Dhe ka qenë në
15 atë vend pothuajse gjatë gjithë kohës së periudhës së mbuluar
16 nga aktakuza.

17 Të lidhësh faktorë jorelevantë me atë që dëshmitarët në
18 fakt kanë parë në terren gjatë periudhës së mbuluar nga
19 aktakuza është pika e vetme që Trupi Gjykses do duhej të
20 kishte vlerësuar lidhur me dëshmitarët.

21 Së fundmi, Fatmir Humolli. Familja e tij ka qëndruar aty
22 dhe ka kërkuar strehim. Pra, ai ka qenë aty, ka shkuar, por Z.
23 Humolli ka një pozicion të veçantë, qëndrimi i tij është i
24 veçantë lidhur me Dhomat e Specializuara të Kosovës.

25 Qëndrimi i tij është personal; ai ka të drejtë të lirë të

1 shprehë këtë si e drejta e lirisë së fjalës. Gruaja e tij pas
2 luftës u bë paciente e doktoreshës Teuta Hadri, e cila dëshmoi
3 se ka qenë aty në kompleks që ka ndihmuar për të operuar
4 pacientët.

5 Pra, çfarë lidhje ka opinionin personal i z. Humolli
6 lidhur me DHSK-në me atë që ai ka parë në kompleks kur ka
7 shkuar aty? Trupi Gjykses -- kur ai ishte aty dhe ka shkuar
8 për vizitë dhe ka takuar familjen e tij në oborr.

9 Trupi Gjykses vlerësoi për mendimin e tij personal, një
10 çështje që s'ka absolutisht fare të bëjë me faktet e kësaj
11 lënde. E bëri këtë, pra, në dëm të të akuzuarit. Trupi Gjykses
12 nuk vlerësoi dëshminë e tij siç duhet. Pra, lidhur me atë që
13 pa. Në këtë mënyrë Trupi Gjykses hoqi, largoi një numër të
14 madh dëshmitarësh të cilët thjesht po jepnin dëshmi lidhur me
15 çështje që provojnë të kundërtën e akuzave.

16 Duke patur parasysh -- në pikëpamjen e Mbrojtjes kjo
17 është, kjo përbën gabim gjyqsor. Dëshmitarët duhet të
18 vlerësohen në atë që kanë parë, kanë vërejtur, kanë vëzhguar
19 gjatë kohës kur kanë qenë aty. Të zbatosh ndonjë standard
20 tjetër është thjesht gabim, siç është edhe për ato elementë që
21 kemi ekzaminuar, dëshmitarët në veçanti, dëshmitarët okularë
22 në terren.

23 Për të përmbledhur, Trupi Gjykses nuk ka dhënë vlerësim
24 të duhur dëshmisë së dëshmitarëve të cilët ishin në pozicion
25 të duhur, qoftë për të identifikuar ndërtesat apo vendin apo

1 për të dëshmuar se i akuzuari ka qenë diku tjetër. Sidoqoftë,
2 jo në vendin ku krimet e pretenduara kanë ndodhur.

3 Kur dëshmitarët nuk vlerësohen në mënyrë meritore lidhur
4 me atë që kanë parë dhe vëzhguar, faktet nuk mund të
5 vërtetohen në mënyrë të saktë. Trupi Gjykues nuk i ka dhënë
6 vlerësimin e duhur, peshën e duhur thelbit të dëshmitarëve të
7 Mbrojtjes dhe atë që ata dëshmuajnë për të. Faktet përbëjnë
8 themelin e akuzave. Kjo rezulton në këtë rast në një mënyrë të
9 paduhur të vërtetimit të rrethanave faktike të lëndës dhe kjo
10 përbën gabim gjyqësor.

11 Të nderuar Gjykatës, do kaloj në një temë tjetër dhe me
12 këtë temë do të arrij tek pyetjet e Gjykatës.

13 Ka të bëjë me vrasjen. Trupi Gjykues e ka vlerësuar në
14 paragrafin 624 se e vetmja përfundim i arsyeshëm bazuar në
15 provat në tërësi është se Mbrojtja, viktima-mbrojtës ka vdekur
16 si rezultat i kombinimit mes keqtrajtimit të rëndë të
17 shkaktuar nga pjesëtarë të BIA-s, të cilët e kanë ndaluar atë;
18 kanë shkaktuar dëm të rëndë trupor dhe mohimi i ndihmës
19 mjekësore nga pjesëtarët e BIA-s dhe plagë të shkaktuar nga
20 armë zjarr.

21 Paragrafi 639 përfundon biles se pavarësisht nga plagët e
22 shkaktuara nga arma e zjarrit, vdekja e viktimës i atribuohet
23 të akuzuarit. Megjithatë, lidhur me atribuimin e vrasjes së
24 viktimës do të flas me vonë.

25 Fillimisht filloj me bazën, çështje bazike që kanë të

1 bëjnë me vdekjen. Është fakt në këtë lëndë se, ndonëse,
2 ndërkohë që trupi ishte, ndonëse trupi ishte, kufoma ishte në
3 dispozicion nuk është bërë një zhvarrim dhe asnjë autopsi e
4 kufomës. Kjo mund të ishte bërë në atë kohë, në vitin 1999 ose
5 në një kohë tjetër.

6 Është fakt i pamohueshëm në këtë lëndë që asnjë autopsi
7 *post-mortem*, pas vdekjes, nuk është bërë nga ZPS-ja. Trupi
8 Gjykues në mungesën e kërkesës nga ZPS-ja duhet në çdo
9 rrethanë të përcaktojë të vërtetën në lëndë. Nuk mund ta bëjë
10 këtë, mund ta bëjë këtë përmes mjeteve të ndryshme. Edhe Kodi
11 Penal i Kosovës i referohet një detyrë të tillë në pajtim me
12 nenin 7(1) të Kodit të Procedurës, Kodit të Procedurës Penale
13 në Kosovë, i cili ka të bëjë me se faktet e lëndës duhet të
14 vërtetohen në tërësi dhe që janë të rëndësishme me qëllim që
15 të jepet të lëshohet një vendim ligjshëm dhe ligjor. Artikulli
16 7(1) i Kodit Kriminal të Kosovës.

17 Nën bazuar në rregullën 137(1) [sipas përkthimit] të
18 rregullës së Procedurës Gjyqësore, Trupi Gjykues duhet të
19 thërriste provat që i vlerëson të nevojshme për përcaktimin e
20 së vërtetës, për të përcaktuar të vërtetën. Trupi Gjykues
21 duhet dhe besojmë duhet të përdorë këtë rregull bashkërisht me
22 rregullën 40 të rregullës të Procedurave të Provës si dhe
23 nenin 19 të Ligjit mbi Dhomat e Specializuara dhe në lidhje me
24 nenin 7 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të 2012 që
25 sapo e përmenda.

1 Rregulla 40 e Rregullores saktëson se atë që kërkohet
2 për të përcaktuar, kriter, kërkon për përcaktuar për të bërë
3 ekzaminimin *post-mortem*. Këto janë identiteti, shkaku dhe koha
4 e vdekjes dhe natyra e plagëve. Konstatimet nga autopsia e
5 kufomës mund të japin përgjigje pyetjeve të tilla apo të
6 ngelen pavërtetuara këto elemente ose më mirë këto konstatime
7 në rregullat e mësipërme janë aty për një arsye.

8 Konstatimet mbi trupin e të vdekurit kërkojnë gjëra
9 konkrete minimumi që përcaktojnë natyrën e vdekjes. Përndryshe
10 pa ndonjë dëshmi apo dëshmitar okular këto aspekte specifike
11 bëhen thjesht spekulime.

12 Kur e vërteta në një rast që përfshin që ka të bëjë me
13 vdekjen e një personi nuk mund të përcaktohet në mënyrë të
14 padyshimtë, vetëm dëshmitarët okularë mund të sjellin më shumë
15 dritë, të ndriçojnë këtë rast. Në këtë rast që kemi ne, nuk
16 kemi patur dëshmitarë të tillë, dëshmi nga dëshmitarë okularë
17 të tillë.

18 Këto çështje konkrete janë të rëndësishme edhe për
19 atribuimin e vdekjes njërit apo më shumë kryerësve. Pa kohën e
20 vdekjes disa ose më shumë kryerës duhet të përjashtohen.

21 Dhe që nuk ka kohë, që -- trupi i tij u gjet në 6 shkurt,
22 në 6 qershor [sipas përkthimit]. Herën e fundit që u pa ishte
23 nga të bashkarrestuarit ishte me 19 prill, as nuk ka asnjë
24 provë që nga një nga dëshmitarët kanë qenë në kontakt me këtë
25 person pas datë 19.

1 Për rrjedhojë është spekulative të konkludojmë që koha e
2 vdekjes, se vdekja e viktimës mund të ketë qenë brenda kohës
3 së aktakuzës dhe nuk ka asnjë provë për të mbështetur një
4 pretendim të tillë. Për rrjedhojë është e pamundur që i
5 akuzuari të shpallet fajtor për akuzën e vrasjes siç është
6 paraqitur në aktakuzë.

7 Edhe vetë Trupi Gjykses, të nderuar Gjykatës, i cili u
8 përpoq të vërtetonte, të përcaktonte nëse ai ka mund të vdesë
9 në një periudhë kohore të caktuar as -- kërkoj ndjesë -- edhe
10 vetë, as Trupi Gjykses nuk arriti, i cili u përpoq të
11 përcaktonte nëse personi mund të ketë vdekur në një periudhë
12 kohore të caktuar, as Trupi Gjykses nuk arriti të përcaktojë
13 nëse viktima vdiq pas periudhës kohore të konstatuar.

14 Në paragrafin 64 [sipas përkthimit] të gjykimit dhe po
15 citoj këtu, atë që thotë Trupi Gjykses:

16 "Lidhur me këtë, Trupi Gjykses nuk është në gjendje që të
17 përcaktojë kur vdiq viktima e vrasjes. Të paktën me një lloj
18 për afërsie gjatë periudhës kohore të lartpërmendur apo më
19 pas".

20 Për rrjedhojë Trupi Gjykses nuk mund të mbajë qëndrimin
21 se viktima e vrasjes u vra qoftë edhe përpara datës 30 prill.
22 Ata nuk trajtuan këtë çështje fare në aktgjykim. Edhe në qoftë
23 se e kanë bërë nuk ishin në gjendje që të përcaktonin kur
24 viktima e vrasjes vdiq. Pra, nuk ka prova të pamohueshme; kur
25 ai ka vdekur, është thjesht spekulative. Të thuhet që ai vdiq

1 mes 19 dhe 30 prillit dhe kjo është tejet e rëndësishme për
2 akuzën e ngritur në aktakuzë.

3 Trupi Gjykues përdori atë që përbën shkakun themelor të
4 vdekjes. Do ta shpjegoj këtë më vonë, por nuk e arsyetoj pse
5 shkakun themelor i vdekjes do të ishte në periudhën kohore
6 midis 19 dhe 30 prillit. *Actus reus* nuk mund të veçohet nga
7 periudha kohore brenda së cilës ka ndodhur me qëllim që i
8 akuzuari të shpallet fajtor për krimin e luftës së vrasjes siç
9 është formuluar në aktakuzë. La hapur mundësinë viktime mund
10 të ketë vdekur pas prillit 1999, në veçanti duke marrë
11 parasysh faktin që ai është gjetur në korrik.

12 Edhe sikurse viktime të kishte, të ketë vdekur pas
13 pushimit të luftës, kjo do të ishte krim lufte. Koha e vdekjes
14 është e rëndësishme, sa i përket akuzave. Vdekja që ka ndodhur
15 jashtë periudhës kohore të mbuluar nga akuzat nuk mund të jetë
16 fajtor.

17 Po ashtu është e panjohur se vendi ku, vendi i vdekjes
18 edhe pse kufoma është gjetur në zonën e Zllashit, ne thjesht
19 nuk e dimi se ku vdiq. Vendi i vdekjes është po ashtu i
20 rëndësishëm lidhur me akuza siç janë paraqitur në aktakuzë.

21 Trupi Gjykues nuk përcaktoi vendin e vdekjes dhe nuk ka
22 prova që viktime në fakt u vra në kompleks. [REDAKTUAR]
23 [REDAKTUAR]. Megjithatë, Aktakuza e Konfirmuar, në
24 Aktakuzën e Konfirmuar thuhet, deklarohet se ai është vrarë në
25 kompleksin e ndalimit të Zllash.

1 Trupi Gjykses nuk e trajtoi këtë çështje. Ndonëse viktima
2 mund të ketë qenë keqtrajtuar në një vend ai mund të jetë
3 vrarë në një vend tjetër dhe në fakt edhe nga kushdo tjetër.

4 Lidhur me kohën dhe vendin e vdekjes Mbrojtja pohon vendi
5 dhe koha e vdekjes së viktimës nuk është vërtetuar dhe për
6 rrjedhimisht ky gabim zhvlerëson aktgjykimin. Provat na çojnë
7 në përfundime të tjera të arsyeshme.

8 Mbrojtja parashtron se, Mbrojtja parashtron - kërkoj
9 ndjesë - se në qoftë se as koha, as data, as vendi në kompleks
10 nuk vërtetohen akuzat e ngritura në Aktakuzën e Konfirmuar nuk
11 mund të provohen, vërtetohen përtej dyshimit të arsyeshëm.
12 Pra, kur nuk ka prova të plota dhe bindëse se ku vdiq, thjesht
13 është spekulative të thuhet se ai vdiq në kompleksin e
14 ndalimit në Zllash. Dhe për rrjedhojë akuza nuk mund të
15 vërtetohet dhe kjo është tejte e rëndësishme kritike për
16 akuzën në aktakuzë.

17 Për të përmbledhur, Trupi Gjykses nuk arriti të
18 vërtetonte se këto dy çështje, koha dhe vendi, lidhur me
19 vdekjen e viktimës në këtë rast Trupi Gjykses nuk mund të
20 shpallte të akuzuarin fajtor siç është akuzuar.

21 Me qëllim që të përcaktojmë të vërtetën në një lëndë, në
22 veçanti kur bëhet fjalë për vrasje është e nevojshme e
23 domosdoshme të përcaktohet minimalisht çfarë shkaktoi vdekjen
24 dhe kur u shkaktua vdekja.

25 Tani do të flas për shkakun e vdekjes. Sepse asnjë nga të

1 bashkëndaluarit nuk mund të përcaktojnë nëse plagët apo
2 lëndimet që kishe ky person mund të kenë shkaktuar vdekjen.
3 Asnjë nga të bashkakuzuarit nuk është i kualifikuar që të bëjë
4 përcaktime të tilla, siç u tha më lart. Nuk është bërë asnjë
5 autopsi dhe nuk ka raport të tillë.

6 Ajo që ne dimë është se viktima ishte gjallë në kohën kur
7 personat e tjerë mbaheshin të ndaluar dhe janë liruar. Askush
8 pas këtij momenti nuk e ka parë më këtë person. Pra, gjithçka,
9 çdo gjë që ka të bëjë me gjendjen e tij, në qoftë se atij i
10 është dhënë ndihmë mjekësore apo jo, është thjesht spekulim.
11 Mohimi i ndihmës mjekësore është supozim për të cilin nuk ka
12 bazë faktike.

13 Trupi Gjykues bëri deduktime lidhur me gjendjen e tij dhe
14 sipas Mbrojtjes këto rezultojnë në përfundimin që ai ka vdekur
15 apo ka vdekur si pasojë e këtyre lëndimeve apo plagëve.
16 Njerëzit që kanë gjetur trupin, kufomën, kanë deklaruar se
17 viktima kishte vrime në trupin e tij. Me gjasë vrime plumbash.
18 Nuk është e kontestueshme që asnjë nga dëshmitarët nuk ka
19 folur lidhur me viktimën në kohën e ndalimit nuk ka përmendur
20 vrime plumbash në trupin e tij. Për rrjedhojë, këto vrime
21 plumbash mund të jenë shkaktuar, duhet të jenë shkaktuar pas
22 lirimit të të ndaluarve.

23 Trupi Gjykues në paragrafin 637 të aktgjykimit thotë:

24 "Ekziston në fakt një dyshim i arsyeshëm lidhur nëse
25 vrimat e plumbave të identifikuar në trupin e viktimës së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 47

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 vdekjes mund t'i atribuohen pjesëtarëve të BIA-s apo trupave,
2 forcave serbe".

3 Për sa i përket refuzimit të ndihmës mjekësore, kjo varet
4 nga rrethanat. Në lidhje me këto çështje është me rëndësi në
5 qoftë se ka në dispozicion ndihmën mjekësore. Kjo varet nga
6 shumë faktorë të cilët nuk mund të përcaktohen në mënyrë të
7 thjeshtë. Sido që të jetë, në aktgjykim ato nuk u përcaktuan.

8 Është e panjohur se me çin ishte personi kur të ndaluarit
9 e tjerë u larguan nga ai vend për të shkuar në Prishtinë. Në
10 qoftë se viktima mbeti aty vetëm nuk dihet. Gjithashtu nuk
11 dihet se me çin ishte viktima dhe me të cilin mbeti aty.

12 [REDAKTUAR] i cili thuhet se ka mbetur aty në
13 vendin e ndalimit edhe ai nuk u gjet asnjëherë dhe nuk ka
14 njohuri për këtë person. Por askush nuk di në qoftë se kishte
15 edhe njerëz të tjerë në atë vend. Nuk e dimë në qoftë se ata
16 njerëz, në qoftë se kanë qenë të pranishëm, ka qenë ushtarë të
17 UÇK-së nga brigada, nga BIA apo nga ndonjë njësi tjetër apo në
18 qoftë se kishte dhe civilë. Nuk u paraqitën prova në këtë
19 drejtim dhe çdo gjë është thjesht spekulim në këtë drejtim.

20 Gjithashtu është e paqartë në qoftë se viktimës iu ofrua
21 ndihmë mjekësore. Trupi Gjykues nuk mund të deduktojë
22 disponueshmërinë apo jodisponueshmërinë e ndihmës mjekësore në
23 bazë të fakteve të paraqitura. Ne këtë thjesht nuk e dimë dhe
24 nuk mund të as Trupi Gjykues të nxjerrë si përfundim se
25 viktimës iu mohua ndihma mjekësore. Aq më pak të deduktojë se

1 ish-in pikërisht anëtarët e BIA-s ata që ia mohuan këtë ndihmë
2 mjekësore.

3 Thjesht nuk ka kurrfarë prove në lidhje me atë se kush ia
4 mohoi këtë ndihmë mjekësore atij personi dhe në qoftë se ai
5 person ishte vartës i Salih Mustafës apo në qoftë se Salih
6 Mustafa ishte në dijeni që ai person ishte aty në atë gjendje.

7 Në qoftë se personi u evakuua ose jo mbetet edhe kjo një
8 çështje e pazgjidhur. Nuk është e qartë në qoftë se mund të
9 bëhej evakuimi i atij personi apo në qoftë se ai vdiq gjatë
10 evakuimit. Thjesht nuk e dimë këtë.

11 Edhe pse rregullat mundësojnë mjetet për të nxjerrë
12 përfundimet kjo nuk u bë nga Trupi Gjykses. Kjo e bën të
13 pavlefshëm aktgjykimin në lidhje me akuzën e vrasjes, sepse
14 nuk u përcaktua koha e vdekjes, vendi i vdekjes dhe arsyeja e
15 vdekjes. Trupi Gjykses vetëm dëgjoi dëshmitë e dëshmitarëve që
16 e panë viktimën në kohën kur viktimja ishte gjallë dhe Trupi
17 Gjykses dëgjoi vetëm dëshmitë nga dëshmitarë okularë të
18 njerëzve që e gjetën trupin apo kufomën e personit pas vdekjes
19 së tij.

20 Këto dy grupe dëshmish nxjerrin në dritë një çështje
21 tjetër. Dëshmitarët okularë në dëshmitë e tyre, në lidhje me
22 kohën kur viktimja ishte ende gjallë, thanë që nuk kanë parë
23 shenja plagësh të shkaktuara nga armë zjarri.

24 Në qoftë se personi u lirua ose nuk u lirua, moslirimi i
25 viktimës që i atribuohet të akuzuarit as viktimat vetë dhe as

1 personat që i liruan viktimat nuk dëshmuan në këtë drejtim dhe
2 nuk ekziston dokumentacion shkresorë në dosjen e çështjes. I
3 vetmi dokument që ekziston është lista e të burgosurve.
4 Mirëpo, aty nuk shkruan asnjë datë e lirimit të mundshëm të
5 tyre.

6 Nuk ka kurrfarë baze faktike për Trupin Gjykues të
7 nxjerrë përfundimin se i akuzuari ka marrë vendimin për
8 moslirimin e viktimës. Megjithatë, Trupi Gjykues konstatoi se
9 kjo ishte vendimi i të akuzuarit. Pra, të mos ta lironte, të
10 mos e lironte këtë person. Në paragrafin 636 të aktgjykimit
11 thuhet:

12 "Si konfirmim që vendimi për moslirimin e viktimës së
13 vrasjes së paligjshme mund të merrej vetëm nga i akuzuari si
14 komandant i BIA-s, Trupi Gjykues i referohet faktit të lirimit
15 të ndaluarve tjerë që u kryen nga vartësit e të akuzuarit në
16 BIA, konkretisht nga zëvendësi i tij z. Mehmetaj".

17 Fakti që është fakt se z. Mehmetaj e mohoi një gjë të
18 tillë gjatë dëshmisë së tij dhe madje edhe nuk ishte në atë
19 kohë vartës apo zëvendëskomandant i të akuzuarit.

20 Dhe ai e shpjegoi gjatë dëshmisë së vet rolin e vet në
21 BIA në atë kohë. Dhe kjo është në paragrafin 338 të
22 aktgjykimit:

23 "Pozita e tij si komandant konfirmohet nga fakti se deri
24 në shkurt të viti 1999, z. Mehmetaj, i njohur gjithashtu si
25 Bimi ishte zëvendësi apo ndihmësi i parë i të akuzuarit. Kurse

1 nga shkurti '99 deri më 21 prill të atij viti ishte Isa
2 Kastrati dhe më pas Bahri Gashi, ata që ishin zëvendës të
3 tij".

4 Me fjalë të tjera, në kohën kur njerëzit u liruan,
5 Ibrahim Mehmetaj nuk ishte i përfshirë më në BIA dhe aq më pak
6 nuk ishte zëvendës i të akuzuarit.

7 Mohimi i ndihmës mjekësore ose vendimi për moslirimin e
8 viktimave nuk mund t'i atribuohet të akuzuarit. Këta dy
9 faktorë janë faktori kryesor i përfundimit të Trupit Gjykues
10 që i akuzuari është fajtor për akuzën e vrasjes. Mbrojtja
11 parashton se këto konstatime nuk bazohen në fakte, në një
12 bazë të fuqishme dhe duhet të hidhen poshtë.

13 Kur faktet e një çështjeje nuk mbështeten në një bazë të
14 fuqishme atëherë edhe përfundimet e nxjerra nga ato fakte nuk
15 mund të jenë të fuqishme për të konfirmuar një vendim fajësie.
16 Dhe për mendimin e Mbrojtjes asnjë gjykatë tjetër e arsyeshme
17 nuk do të mund të kishte nxjerrur këtë përfundim.

18 Pyetjet e Trupit - më falni - të Panelit të Apelit.

19 Pyetja 1(a) në lidhje me shkakun thelbësor, përgjigja e
20 shkurtër në këtë pyetje 1(a) është: Jo. Për mendimin e
21 Mbrojtjes, Trupi Gjykues nuk zbatoi standardin e nevojshëm të
22 shkakut thelbësor. Ajo, Trupi Gjykues, la, nuk mori parasysh
23 disa elemente. Elementi i parë është koha dhe i dyti element
24 është përjashtimi i çdo arsye tjetër të vdekjes.

25 Sa i përket elementit të kohës Mbrojtja parashton se

1 viktimat [sipas përkthimit] e viktimës ishin një kusht *sine*
2 *qua non* për vdekjen e tij dhe në këtë rast ato duhej kjo duhej
3 të ishte vërtetuar se vdekja e tij ndodhi një kohë të shkurtër
4 pas lëndimeve të tilla. Duhet të ketë një lidhje të
5 drejtpërdrejtë midis lëndimeve të pësuarra dhe vdekjes. Me
6 fjalë të tjera lëndimet e pësuarra duhet të jenë shkak i
7 drejtpërdrejtë i vdekjes.

8 Me përjashtimin e shkaqeve të tjera të vdekjes, Mbrojtja
9 parashtron se të gjitha shkaqet e tjera të mundshme të vdekjes
10 duhet të eliminohen. Megjithatë Trupi Gjykues nuk ja eliminoi
11 ato shkaqe siç është rasti me lëndimet e shkaktuara nga armë
12 të zjarrit, nga armë zjarri. Këto lëndime që u gjetën në
13 kufomën e viktimës janë lëndime të reja, në kuptimin që
14 asnjëri nga dëshmitarë që dëshmuan gjatë gjykimit nuk përmendi
15 lëndime të tilla të kish parë në viktimën e vrasjes së
16 paligjshme.

17 Trupi Gjykues e la këtë jashtë periudhës kohore brenda së
18 cilës ishte vrarë personi. Viktima u gjet në korrik me 6
19 korrik afër një kufome tjetër. [REDAKTUAR]
20 [REDAKTUAR].

21 Trupi Gjykues nuk përjashtoi mundësinë që vdekja të
22 kishte ndodhur nga lëndime të shkaktuara me armë zjarri. Trupi
23 Gjykues nuk eliminoi mundësitë tjera apo shkaqe të tjera të
24 mundshme të vdekjes.

25 Pyetja 1(b). Përgjigja e shkurtër në këtë pyetje është,

1 po. Kur lidhja shkakësorë shkaputet për shkak të një ngjarje
2 të re të mëparshme që mund në masë të barabartë të shkaktojë
3 vdekjen Mbrojtja parashton se kjo ndikon në standardin e
4 shkakësisë.

5 Trupi Gjykues e mori si të mundshme në bazë të
6 deklaratave të dëshmitarëve që kishte një numër ngjarjesh
7 ndërhyrëse. Megjithatë, nuk arriti që ta përcaktonte këtë, por
8 nuk e përjashtoi këtë mundësi. Trupi Gjykues e la të hapur
9 mundësinë e këtyre ngjarjeve të reja ndërhyrëse edhe pse nuk e
10 tha këtë shprehimisht, por e tha në mënyrë të nënkuptuar.
11 Midis këtyre faktorëve ndërhyrës të rinj janë granatimi nga
12 ana e forcave serbe që po i afroreshin kompleksit dhe të
13 cilave mundësisht kishin qasje te viktima.

14 Dhe gjithashtu Trupi Gjykues e la të hapur çështjes e
15 kohës se kur vdiq viktima. Kjo është në paragrafin 634 të
16 aktgjykimit.

17 Mbrojtja, për sa i përket ndikimit të ngjarjeve të reja
18 ndërhyrëse mbi standardin e shkakësisë në veprën penale të
19 vrasjes gjykon këto ngjarje të reja, sikurse janë konfirmuar
20 nga Trupi Gjykues në pikën 634 dhe 637 të aktgjykimit ishin të
21 mundshme, domethënë, ndërprerje të mundshme të lidhjes
22 shkakësore midis veprimeve dhe mosveprimeve të të akuzuarit
23 dhe vdekjes së viktimës.

24 Është e mundur që vdekja të ketë ndodhur nga një veprim i
25 pavarur dhe pavarësisht këtyre lëndimeve të marra. Domethënë,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 53

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 mund të konsiderohet se kishte njëfarë shkëputjeje në lidhjen
2 shkakësore midis veprimit apo mosveprimit të akuzuarit dhe
3 shkakut të vdekjes.

4 Ndikimi është i thjeshtë. Këto mundësi, mundësia e
5 ngjarjeve të reja ndërhyrëse ka ndodhur dhe nuk mund të
6 përjashtohet në bazë të parimit in *dubio pro reo*.

7 E di që e kam kaluar kohën që më është caktuar, por jam
8 nga fundi.

9 Përgjigja e shkurtër në pyetjen 2 është, jo. Kur nuk ka
10 shkakësi nuk ka edhe vrasje. Kur nuk ka vrasje atëherë nuk ka
11 edhe përgjegjësi penale për vrasjet në asnjë formë të
12 përgjegjesisë penale. Të paktën jo nga i akuzuari as në nivel
13 personal dhe as në kontekst të ndërmarrjes kriminale të
14 përbashkët apo si epror.

15 Sipas nenit 20 të Kodit Penal të Kosovës:

16 “Një person nuk mban përgjegjësi penale kur nuk ka një
17 lidhje shkakësore midis veprimit të tij apo mosveprimit të tij
18 dhe pasojës”.

19 Megjithatë, meqë nuk ka prova materiale që do të
20 vërtetonin se vdekja e viktimës ishte rezultat i lëndimeve
21 trupore që iu shkaktuan nga përdorimi i një arme, atëherë
22 lidhja shkakësore midis veprimit dhe mosveprimit të akuzuarit
23 dhe vrasjes së viktimës nuk mund të vërtetohet.

24 Në çështjen Tadic të Tribunalit Penal për ish-
25 Jugosllavinë, çështja IT-94-1-T të datës 17 [sipas përkthimit]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 54

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 maj 1997, Trupi Gjykses në paragrafin 240 të aktgjykimit

2 thotë:

3 "Megjithatë, duhet të ketë prova që lidhin pasojat,
4 lëndimet e marra me vdekjen".

5 Këtë Prokuroria nuk e ka vërtetuar. Edhe pse Mbrojtja nuk
6 e ka ngritur këtë çështje i takon Trupit Gjykses që ta bëjë
7 këtë. Por Trupi Gjykses nuk ka për detyrë të nxjerrë
8 përfundime dhe aq më pak përfundime që nuk janë në favor të të
9 akuzuarit.

10 Tani do t'i kthehem pikës 9(c), (d), (e) dhe (f) aty do
11 ta përfundoj edhe prezantimin apo përfundimet e mia.

12 Dhe kjo lidhet është me zbatimin e gabuar apo moszbatimin
13 e *lex mitior*-it. Në fakt është zbatimi i gabuar i nenit 44(2)
14 të Ligjit që përbën shkelje kushtetuese të të drejtave të të
15 akuzuarit.

16 Parimet bazë të Kushtetutës së Kosovës të përcaktuar në
17 nenin 3(2) të Ligjit për DSK-në përcaktojnë se Dhomat e
18 Specializuara do të gjykojnë dhe funksionojnë në pajtim me
19 Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo dispozitë ka dy
20 pjesë, që Dhomat e Specializuara duhet të gjykojnë dhe pjesa e
21 dytë, "të funksionojnë në pajtim" me.

22 Së pari, fjala "do të" duhet të interpretohet në atë
23 mënyrë që nuk lenë hapësirë për një interpretim sipas të cilit
24 një trup gjykses i DSK-së mund të gjykojë ashtu siç don apo
25 ashtu sikurse preferon. Duke qenë se e drejta zakonore

1 ndërkombëtare është *lex mitior*-i në këtë rast.

2 Sa i përket formulimit "do të" dhe "në përputhje me", në
3 këtë nen kjo është mjaft e qartë. Në Kosovë dhe në shoqëritë e
4 tjera në kushtetuta të shkruara, në gjykata dhe në
5 institucione të funksionit publik, kushtetuta është ligji më i
6 lartë i një vendi. Kushtetuta kombëtare e një vendi parashikon
7 disa garanci procedurale bazë të cilat reflektojnë të drejtat
8 ndërkombëtare njerëzore. Dhe kjo nuk vlen vetëm për Kosovën,
9 por vlen për të gjitha vendet që u krijuan pas rënies së
10 komunizmit.

11 Dhe këtu përcaktohet parimi i ligjshmërisë dhe
12 proporcionalitetit në çështje penale. Një relevancë
13 veçanërisht e rëndësishme për këtë çështje ka paragrafi 2 dhe
14 4 i nenit 33 ku thuhet:

15 "Asnjë dënim për vepra penale nuk duhet të jetë më i
16 lartë se dënimi i parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së
17 veprës penale".

18 Dhe paragrafi 4 që thotë:

19 "Dënimi duhet të jepet në përputhje me ligjin që ishte në
20 fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale me përjashtim në
21 qoftë se një ligj i mëvonshëm parashikon një dënim më të
22 favorshëm për kryesin".

23 Këto janë dy dispozita kyçe që mishërojnë parimin *lex*
24 *mitior* në Kushtetutën e Kosovës. Dhe kjo gjithashtu
25 parashikohet në nenin 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat

1 e Njeriut që është burimi më i lartë ligjor për vlerat dhe të
2 drejtat njerëzore.

3 Dhe aty në këtë nen thuhet:

4 "Nuk duhet të caktohet një dënim më i rëndë se ai që
5 është paraparë në ligjin e zbatueshëm në kohën e kryerjes së
6 krimit".

7 Neni 44 i DHSK-së i Ligjit për DHSK-në gjithashtu thotë
8 se regjimi i caktimit të dënimit për krimet e parashikuara në
9 ligjet e Kosovës në kohën e kryerjes së krimit të gjitha këto
10 dispozita përfshihen edhe në paragrafin 780 të aktgjykimit ku
11 thuhet, në qoftë se do të ishte ashtu sikurse Trupi Gjykues në
12 atë paragraf kjo do të kishte domethënien se në këtë nen bie
13 ndesh me nenin 33(2) dhe (4) të Kushtetutës së Kosovës e cila
14 siç thashë është dokumenti më i lartë ligjor dhe e detyron
15 Trupin Gjykues në të njëjtën kohë që të përfaqësojë parimin e
16 *ius cogens* në të drejtën zakonore ndërkombëtare.

17 Trupi - më falni - Mbrojtja dëshiron të ritheksojë se
18 dispozitat e nenit 33(2) dhe (4) të kushtetutës garantojnë
19 disa të drejta të akuzuarit dhe ai ka mbrojtje në bazë të
20 këtyre garancive të përcaktuara në kushtetutë.

21 Mbrojtja parashtron se fakti që Trupi Gjykues nuk iu
22 përmbajt dispozitave të këtij neni, dënimi që caktoi shkeli të
23 drejtat kushtetuese të të akuzuarit. Kjo nuk ishte në
24 përputhje me nenin 3 të Ligjit për DHSK-në dhe ishte në
25 kundërshtim me nenin 33 të kushtetutës me pasoja të

1 drejtpërdrejta juridike që e bëjnë të pavlerë aktgjykimin.

2 Të drejtat e njerëzve të parapara në Kushtetutën e
3 Kosovës dhe në juridiksionin më të gjerë janë plotësisht të
4 zbatueshme në këtë rast. Në përputhje me nenin 113.8 të
5 Kushtetutës kjo është me rëndësi, sepse rregullon të
6 ashtuquajturën kontrollin incidental të kushtetutshmërisë dhe
7 përcakton si vijon:

8 "Gjykatat kanë të drejtë që të referojnë pyetjet që kanë
9 të bëjnë me përputhshmërinë kushtetuese të ligjit përpara
10 Gjykatës Kushtetuese dhe mund t'i referojnë vendimin e
11 gjykatës përkatëse sa i takon përputhshmërisë së ligjit që
12 është pjesë e diskutimit".

13 Neni 49(4) i Ligjit për Dhomat e Specializuar të Kosovës
14 ka të njëjtin formulim. Ekzaktësisht të njëjtin formulim si më
15 lart.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Ju lutem, a
17 mund të përfundoni tani?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, do përfundoj.

19 Po do përfundoj. Kam edhe pak argumente për të
20 parashtruar, të nderuar Gjykatës.

21 Në përputhje me sa më lart, në rastin e Trupit Gjykses,
22 në qoftë se Trupi Gjykses mban të njëjtat pikëpamje sa i takon
23 parimeve të *lex mitior*-it, ne dëshirojmë që t'i propozojmë
24 Gjykatës së Apelit që të vërë në lëvizje proceset për
25 kushtetutshmërinë dhe kontrollin e kushtetutshmërisë në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 58

Parashtrime nga Mbrojtja

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 përputhje me nenin 113(8) të kushtetutës dhe 48(4) të Ligjit
2 të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

3 Mbrojtja parashtron se interpretimi i Trupit Gjykues dhe
4 zbatimi apo më mirë të themi moszbatimi i kësaj dispozite të
5 ligjit është jokushtetuese, por bie ndesh me kushtetutën pasi
6 shkel dispozitat e kushtetutës së lidhur me ligjshmërinë e
7 dënimit që përfaqësojnë një standard ndërkombëtar. Gjithashtu
8 edhe parimin e *lex mitior*.

9 Parashtroj, të nderuar Gjykatës, që Mbrojtja i qëndron
10 qëndrimin që në qoftë se Dhoma e Apelit nuk gjen një konstatim
11 ose nuk vendos për moszbatimin nga Trupi Gjykues të nenit
12 44(2) të Trupit Gjykues [sipas përkthimit], ajo duhet që të
13 përdorë mundësinë kushtetuese dhe t'i drejtohet Gjykatës
14 Kushtetuese për një interpretim.

15 Të nderuar Gjykatës, me këtë dëshiroj të përfundoj
16 parashtrimet e Mbrojtjes dhe ju falënderoj shumë për dëgjuesën.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Sikurse
18 parashikohet edhe në urdhrin për zhvillimin e seancës tani do
19 bëjmë pushim për 30 minuta, çfarë do të thotë që do të
20 mblidhemi këtu përsëri në orën 15.50.

21 --- Pauza fillon në orën 15.22

22 --- Seanca rifillon në orën 15.51

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Do ftoja
24 Zyrën e Prokurorit që të paraqiste përgjigjet e veta. Keni një
25 orë e 30 minuta në dispozicion dhe pasi të keni përfunduar me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 59

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 parashtrimet tuaja, do të përfundojmë ditën e sotme.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuar
3 Kryegjykatëse, do të mundohemi që t'i qëndrojmë orarit të
4 planifikuar.

5 Të nderuar Gjykatës, prezantimi i ZPS-së sot do të ndahet
6 në tri pjesë. Së pari do të fillojmë duke theksuar disa
7 elementë të përzgjedhur të çështjes gjyqësore, duke u
8 përqendruar tek përgjegjësia e z. Mustafa për krimet e
9 pretenduara në aktakuzë. Më pas, kolegu im, z. Baarlink, do të
10 vazhdojë më tej me diskutimin e përqendruar tek pika e akuzës
11 për vrasje, e cila është përcaktuar edhe më datën 12 tetor
12 2023, në urdhrin për përgatitjen për seancën e apelit,
13 përfshirë këtu edhe lidhjen shkakësore, ndikimin e ngjarjeve
14 ndërhyrëse, format e përgjegjësisë penale dhe standardin *mens*
15 *rea*. Më pas znj. Lawson do të vazhdojë me komentet përmbyllëse
16 lidhur me dënimin e z. Mustafa.

17 Më lejoni mua të vazhdoj.

18 Në çështjen në fjalë, të nderuar Gjykatës, Salih Mustafa
19 u deklarua fajtor për ndalim arbitrar, për torturë dhe vrasje
20 si krime lufte, dhe u dënua me 26 vite burgim. Atij iu vu në
21 dispozicion gjykimi i drejtë, pati mundësinë që të vlerësonte
22 dhe të kundërshtonte dëshmitë e paraqitura kundër tij, dhe
23 gjithashtu iu lejua që të prezantonte të gjitha dëshmitë e
24 propozuara në mbështetje të çështjes së tij.

25 Trupi Gjykses gjykoi plotësisht akuzat e ngritura kundër

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 60

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 z. Mustafa duke vlerësuar mbrojtjen e tij dhe pretendimet për
2 gjykim të drejtë, ka lëshuar gjithashtu edhe vendime të
3 arsyetuara dhe ka miratuar mjete juridike kur ka qenë e
4 përshtatshme. Aktgjykimi është i hollësishëm, është i
5 arsyetuar dhe i mbështetur në prova të besueshme dhe të
6 mbështetshme dhe duhet të lihet në fuqi.

7 Të nderuar Gjykatës, përderisa Trupi Gjykues ka
8 përcaktuar saktë krimet e akuzuara në aktakuzë që kanë ndodhur
9 në prill të vitit 1999, në Zllash, në një fshat të vogël të
10 largët të vendosur në malet e rajonit të Gollakut në lindje të
11 Prishtinës, në kryeqytetin e vendit në Kosovë.

12 Zllashi në diapozitivin që keni përpara është në të
13 djathtë të hartës, është rreth 20 kilometra në rrugën nga
14 Prishtina. Kjo është zona e Zllashit, të nderuar Gjykatës.
15 Dhe, ky është pozicionimi i Zllashit në raport me Prishtinën.

16 Më konkretisht, krimet janë kryer brenda një grupi të
17 ndërtesave të ndërlidhura në një vend që quhet kompleksi i
18 ndalimit të Zllashit. Kompleksi ishte një vend i vogël i
19 izoluar, larg zonave të banuara dhe mund ta shihni në këtë
20 diapozitiv vendndodhjen e tij.

21 Diapozitivi i radhës përshkruan ndërtesat brenda
22 kompleksit të Zllashit ku pretendohet të jenë kryer krimet.
23 Këtu shkurtimisht dëshiroj që t'i përgjigjem parashtrimeve të
24 sotme të mbrojtjes së z. Mustafa lidhur me pretendimin që ZPS-
25 ja ka ndryshuar provat e veta gjatë procesit gjyqësor.

1 Sikurse u mundua që të sqaronte Gjykatësi Ambos dhe
2 pyetjet që i bëri ai, z. Von Bone, siç doli e qartë,
3 Prokuroria që në fillim fare në aktakuzë tha dhe pretendoi që
4 krimet janë kryer në kompleks. Dhe në aktakuzë nuk është
5 përcaktuar asnjëherë ose nuk i kemi përmendur asnjëherë një
6 godinë të vetme. Thjesht kemi, jemi referuar kompleksit dhe
7 këtu kemi thënë pra që brenda kompleksit janë kryer krimet të
8 cilat janë ngritur në aktakuzë dhe këtij qëndrimi i kemi
9 qëndruar deri në fund të gjykimit.

10 Në prill 1999, kompleksi i Zllashit, është drejtuar nga
11 anëtarët e UÇK-së në veçanti nga grupi BIA, që drejtohej nga
12 z. Mustafa, i njohur ndryshe si komandant Cali ose Cali. Siç u
13 konstatua nga Trupi Gjykues, BIA kontrollonte kompleksin duke
14 përdorur atë vend si një prej bazave të veta.

15 Z. Mustafa si komandant i BIA-s ishte përgjegjës për
16 kontrollin e kompleksit.

17 Trupi Gjykues gjykoi dhe vlerësoi dhe shpjegoi në mënyrë
18 shteruese në aktgjykim se të paktën gjashtë viktima janë
19 dënuar, janë ndaluar në këtë kompleks dhe janë trajtuar në
20 mënyrë çnjerëzore në kushte shumë të këqija, për periudha të
21 gjata kohe, janë detyruar që të flenë përdhe, në një ahur për
22 kafshët. Nuk kanë marrë ushqim dhe ujë të mjaftueshëm, si dhe
23 kanë jetuar në kushte sanitare ekstreme. Nuk kanë marrë po
24 ashtu asnjë kujdes mjekësor dhe nuk janë lejuar që të kurohen
25 sa i takon lëndimeve që kanë pësuar nga z. Mustafa dhe nga

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 62

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 vartësit e tij gjatë marrjes në pyetje.

2 Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja paraqiti në procesin gjyqësor
3 një dokument provues shumë të rëndësishëm që konfirmon fort
4 faktin e ndalimit të viktimave. Po flas këtu për listën e të
5 dënuarve, ose të burgosurve siç parashtrohet në viktimat
6 03593, 03594, 01679, dhe viktimën e vrasjes, si dhe shumë
7 persona të tjerë, dhe kemi parashtruar gjithashtu edhe detajet
8 që kanë të bëjnë me emrat e baballarëve të tyre, të datave ose
9 të vendeve të lindjes, vendit të banimit edhe datat e tjera të
10 cilat lidhen me arrestimin ose ndalimin e tyre.

11 Do t'i kërkoja z. Sekretar, që të mos e transmetonte
12 diapozitivin për publikun, ndërkohë që do të vazhdoj që të jap
13 listën e të ndaluarve apo të burgosurve që paraqiten në
14 diapozitivin 4 të prezantimit tim.

15 Të nderuar Gjykatës, kjo është lista e cila në versionin
16 origjinal është në gjuhën shqipe. Është listë e cila nuk është
17 kundërshtuar gjatë Trupit Gjyqës [sipas përkthimit].
18 Vërtetësia, origjina e këtij dokumenti nuk janë kundërshtuar
19 nga Mbrojtja e të akuzuarit. Dhe sikurse mund ta shihni nga
20 lista që keni përpara, kjo listë konfirmon dëshmitë e
21 viktimave që kanë mbijetuar dhe që kanë kaluar kohën e tyre në
22 Zllash. Për shembull, përmes kësaj liste tregohen që kanë qenë
23 të pranishëm 18 [sipas përkthimit] të ndaluar që mbështesin
24 gjithashtu dëshminë e dëshmitarit 3593, ose praninë e emrit të
25 një personi, të emërtuar me emër, të thënë shprehimisht me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 63

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 emër që mbështet dëshminë e 01679, dhe, gjithashtu edhe
2 pyetjet që janë bërë lidhur me marrjen në pyetje të
3 dëshmitarit 3593, apo lidhjet ndërmjet z. Mustafa dhe të
4 ndaluarve nga prania në listë të shënimit "Për Calin".

5 Pas këtij dokumenti që kemi dorëzuar para Trupi Gjykues
6 dhe në qoftë se do të shikojmë faqen e dytë të këtij
7 dokumenti, do shohim që jepen gjithashtu edhe pyetje që i
8 bëhen njërit prej dëshmitarëve dhe gjithashtu shënohet edhe
9 emri për Calin, që i referohet komandantit Cali.

10 Viktimat e ndaluar në kompleksin e Zllashit janë rrahur
11 dhe janë torturuar thuajse çdo ditë, si në ahur ku kanë
12 qëndruar të ndaluar, por gjithashtu edhe në dhomën e marrjes
13 në pyetje në pjesën e sipërme të ndërtesës në katin e epërm të
14 ndërtesës. Të ndaluarit janë marrë në katin e sipërm të
15 ndërtesës individualisht, njëri pas tjetrit dhe janë marrë në
16 pyetje atje. Janë rrahur në mënyrë brutale, janë keqtrajtuar
17 dhe torturuar. Të ndaluarit janë abuzuar gjithashtu edhe
18 psikologjikisht, përfshirë këtu nga ushtarët që hynin në
19 stallë dhe që i kanë rrahur ata dhe i kanë keqtrajtuar ata.
20 Njëra prej viktimave më pas është vrarë.

21 Z. Mustafa vetë ka marrë pjesë në mënyrë të
22 drejtpërdrejtë në keqtrajtim. Dy viktima, 1679 dhe 3593 e kanë
23 përmendur emrin e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë si personi
24 që ka marrë pjesë në marrjen në pyetje dhe në rrahjet, dhe që
25 ka qenë personi që ka mbikëqyrur keqtrajtimin e tyre. 1679,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 64

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 qartë identifikoi z. Mustafa dhe konfirmoi që ndërkohë që ka
2 qenë në Zllash në prill 1999, ai është marrë në pyetje nga z.
3 Mustafa, dhe i cili ishte i akuzuari i parë që, dhe ky ishte
4 personi i parë që e akuzoi atë si spiun, që e shau atë, dhe më
5 pas e rrahu atë deri në momentin kur ai humbi ndjenjat.

6 Viktima tjetër, 3593, po ashtu është marrë në pyetje
7 personalisht dhe është keqtrajtuar nga z. Mustafa i cili në
8 një rast e ka rrahur viktimën me një shkop bejsbolli dhe një
9 rast tjetër ka pretenduar që ta vriste atë dhe ka parë, dhe ka
10 mbikëqyrur gjithashtu edhe anëtarë të tjerë të UÇK-së të cilët
11 e kanë rrahur këtë viktimë.

12 Të dy viktimat në mënyrë të besueshme kanë thënë që z.
13 Mustafa ka qenë i pranishëm dhe është përfshirë dhe vartësit e
14 tij nga njësitë BIA kanë qenë të përfshirë në rrahje, dhe ata
15 kanë sulmuar dhe kanë cenuar psikologjikisht personat e
16 ndaluar në kompleksin e Zllashit.

17 Një konfirmim i fuqishëm për historitë e këtyre viktimave
18 që kontribuon më tej për përgjegjësinë e z. Mustafa ndaj
19 akteve të tij jepet nga raportet mjekoligjore të cilat kanë të
20 bëjnë me dy viktima. Këto raporte konfirmojnë dëmtimet fizike
21 të tyre dhe simptomat psikologjike përfshirë këtu edhe
22 çrregullimin e stresit post traumatik.

23 Të nderuar Gjykatës, të nderuar anëtarë të Trupit
24 Gjykues, tani dua që t'i drejtohem konstatimeve konkrete të
25 Trupit Gjykues sa i takon përgjegjësisë penale të z. Mustafa

1 sa i takon krimeve të ngritura në aktakuzë.

2 Trupi Gjykses konfirmoi praninë e elementëve materialë
3 dhe mendorë lidhur me krimin e ndalimit arbitrar. Duke u
4 përqendruar vetëm thjesht te parimi *mens rea* i z. Mustafa,
5 Trupi Gjykses konstatoi se kjo mbështetej konkretisht në disa
6 elementë. Së pari në pozicionin komandues të z. Mustafa mbi
7 BIA-n dhe kompleksin e ndalimit në Zllashit. Së dyti praninë e
8 tij të konfirmuar në kompleksin e Zllashit në kohët që kanë
9 qenë shumë të rëndësishme për akuzat, përfshirë këtu edhe
10 atëherë kur e ka marrë viktimën e vrasjes në prill 1999, në
11 keqtrajtimin e viktimës 1679 dhe 3593; konstatimi i tretë ka
12 të bëjë me faktin e kompetencave ekskluzive të z. Mustafa për
13 të vendosur për mbajtjen ose për lirimin e të ndaluarve në
14 kompleksin e Zllashit; katër, z. Mustafa ka qenë i
15 ndërgjegjshëm për të ndaluarit në kompleksin e Zllashit, një
16 element tjetër është ndërgjegjësia e pamohueshme e anëtarëve
17 të BIA-së për pranimin dhe ndalimin e viktimave, përfshirë
18 këtu edhe zëvendësin e z. Mustafa në BIA dhe bashkëpunëtorët e
19 tij të ngushtë.

20 Z. Mustafa kishte njohuri për ndalimin e viktimave dhe
21 synimin për t'i mbajtur ato të ndaluar, gjë që siç ka
22 konstatuar Trupi Gjykses, demonstron në mënyrë të veçantë
23 nga fakti që ai ka parë të paktën një të ndaluar që është
24 dërguar në kompleksin e ndalimit në Zllash që ka keqtrajtuar
25 personalisht dy persona të tjerë në Zllash, dhe pasi ka rrahur

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 66

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 3593 ka urdhëruar vartësit e vet të BIA-s që ta kthenin atë
2 mbrapsht në ahurin e ndalimit.

3 Sa i takon torturës, të nderuar Gjykatës, Trupi Gjykues
4 gjithashtu ka vërtetuar ekzistencën e elementeve ligjorë të
5 *actus reus* dhe ka numëruar konstatimet e veta lidhur me
6 përgjegjësinë *mens rea* të z. Mustafa.

7 Trupi Gjykues konstatoi që faktorët që konstatojnë
8 përgjegjësinë *mens rea* të z. Mustafa kanë të bëjnë me
9 pjesëmarrjen personale të z. Mustafa për keqtrajtim fizik dhe
10 psikologjik të 1679 dhe 3593, dhe marrjen e tyre në pyetje
11 përfshirë këtu edhe kryerjen e ekzekutimit të sajuar të 3593
12 dhe rrahjen e tij me shkopin e bejsbollit. Po ashtu, një gjë
13 tjetër që ka të bëjë me pikën e torturës, ka lidhje me
14 pjesëmarrjen e përsëritur të vartësve të z. Mustafa në BIA për
15 keqtrajtim dhe marrje në pyetje të institucionalizuar.

16 *Mens rea* e të akuzuarit mbështetet gjithashtu edhe në
17 mohimin e ushqimit të mjaftueshëm, ujit të mjaftueshëm apo të
18 kujdesit mjekësor apo mundësisë për të përdorur mjediset
19 sanitare për të gjithë të ndaluarit nga anëtarët e BIA-s.
20 Gjithashtu, mbështetet në ndërjegjësimin për kushtet e të
21 dënuarve dhe ambientit të ndalimit.

22 Kështu që mbi këto baza, Trupi Gjykues arriti në
23 përfundimin që shkaktimi i lëndimit të egër dhe vuajtjeve të
24 të ndaluarve nga z. Mustafa dhe nga vartësit e tij të BIA-s,
25 ishte e qëllimshme është bërë për qëllimet e marrjes së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Page 67

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 informacionit për pranimin për ndëshkimin, frikësimin,
2 shtrëngimin ose diskriminimin për shkak të arsyeve politike.

3 Sa i takon akuzave për vrasje, shumë shkurtimisht. Më
4 lejoni të them që Trupi Gjykses me të drejtë konstatoi që
5 viktimat e vrasjes është vrarë në prill 1999 si rezultat i
6 kombinimit ndërmjet keqtrajtimit të rëndë të pësuar të
7 shkaktuar nga anëtarët e BIA-s, të cilët e ndaluan atë dhe që
8 shkaktuan dëmtime të rënda trupore. Së dyti, mohimit të
9 ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s dhe nga plagët të
10 shtënash me armë të shkaktuara nga plumbat të cilët ose janë
11 qëlluar nga BIA, ose nga forcat serbe.

12 Trupi Gjykses konstatoi se këto dy shkaqe janë thelbësore
13 për shkaktimin e vdekjes së viktimës dhe që i atribuohen të
14 akuzuarit në kontekstin e vendimit të vet për të mos e liruar
15 apo për të mos e kuruar viktimën e vrasjes pavarësisht në
16 qoftë se viktimat e vrasjes është goditur nga një ose më shumë
17 plumba serbë.

18 Qëllimisht, Trupi Gjykses, sa i takon qëllimit, Trupi
19 Gjykses konstatoi se përgjegjësia e z. Mustafa mbështetet në
20 pranimin e tij që viktimat nën ruajtjen e tij mund të
21 vriteshin siç demonstrohen me fjalët e veta dhe nga përdorimi
22 i armëve kundër tyre; pësimi i qëllimshëm i keqtrajtimit të
23 ashpër për një periudhë të gjatë kohe nga vartësit e z.
24 Mustafa; gjithashtu një tjetër element ka të bëjë me veçimin e
25 viktimës së vrasjes për keqtrajtim të tillë përjashtimisht të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 68

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 rëndë, përdorimit të objekteve vdekjeprurëse gjatë
2 keqtrajtimeve të tilla, mohimit të ndihmës mjekësore, vendimit
3 të z. Mustafa për të mos e liruar ose për të mos e evakuuar
4 viktimën e vrasjes, duke marrë parasysh ofensivën serbe;
5 braktisjen e tij në kushte shumë pranë vdekjes në një vend të
6 mbyllur dhe mohimi i mundësisë së tij për të shpëtuar, si dhe
7 motivimi për të zhdukur viktimën e vrasjes në mënyrë të tillë
8 që të parandalohet raportimi i kryesve ose masa të tjera
9 shpague.

10 Të nderuar Gjykatës, përpara se sa t'i jap fjalën kolegut
11 tim, dëshiroj shumë shkurt t'i përgjigjem parashtrimeve me
12 shkrim të bëra nga Mbrojtja e z. Mustafa lidhur me pretendimin
13 për anësi të Trupit Gjykses në vlerësimin e dëshmitarëve të
14 Prokurorisë dhe dallimit të bërë ndërmjet dëshmitarëve të
15 Prokurorisë dhe dëshmitarëve të Mbrojtjes.

16 Të nderuar Gjykatës, i jemi përgjigjur në mënyrë të
17 vazhdueshme pretendimeve të z. Von Bone dhe Mbrojtjes së z.
18 Mustafa dhe parashtrimet e hollësishme mund t'i gjeni në
19 paragrafin 71 deri në 83. Nuk kemi shumë kohë në dispozicion,
20 kështu që nuk do t'i përsëris këto parashtrime që kemi bërë më
21 herët, lidhur me këtë pikë por mund t'i gjeni në referencën që
22 ju përmenda pak më sipër.

23 Atëherë, në përgjigjen tonë në apelin e z. Mustafa, ne
24 jemi marrë me mangësitë formale në parashtrimin e tij kështu
25 që nuk do t'i përmendim këtu. Ne besojmë që pjesa më e madhe e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 69

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 parashtrimeve për apelin të dorëzuar nga z. Mustafa, duhet të
2 kundërshtohen dhe nuk duhet të shqyrtohen më tej, domethënë,
3 ne i qëndrojmë këtyre parashtrimeve dhe siç e thashë nuk do ta
4 përsëris më qëndrimin tonë në lidhje me të.

5 Faleminderit shumë, të nderuar Gjykatës, tani dua t'i jap
6 fjalën kolegut tim z. Baarlink që do të trajtojë çështjen
7 tjetër.

8 Z. BAARLINK: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
9 Tani do t'i përgjigjem parashtrimeve të parashtruara sot
10 pasdite lidhur me pikat e apelit të z. Mustafa kundër dënimit
11 të tij për vrasje. Akuza numër 4. Që janë pikat 3, 4, 5. Do të
12 përpiqem gjithashtu t'i përgjigjem pyetjeve që ju, të nderuar
13 Gjykatës, keni parashtruar dhe ndonjë pyetje shtesë që mund të
14 keni.

15 Duke shqyrtuar çështjet e këtij apeli, do të bëjmë mirë
16 po të mos harrojnë vuajtjen e njeriut të cilit i është mohuar
17 mundësia që të tregojë deri historinë e tij në këtë gjykatë.
18 Kjo histori e trishtë filloi më [REDAKTUAR] prill 1999.

19 Viktima e vrasjes po [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 70

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 Në kompleksin e Zllashit viktima e vrasjes iu dorëzua

2 pjesëtarëve të BIA-s nën komandën e Salih Mustafës.

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR].

5 Viktima, emri i viktimës së vrasjes, data, vendlindja, u
6 regjistruan në listën e të burgosurve. Ai u dërgua në një
7 stallë, ahur ku mbahet në kushte të mjerueshme, të përshkruara
8 të papërshtatshme për qeniet njerëzore. Ai fjeti në tokë, në
9 llaç, mbuluar me kashtë dhe ujë. Ajrit i vinte era e
10 jashtëqitjeve të kafshëve. Ditët kalonin dhe ai ishte pa
11 ushqim.

12 Viktima e vrasjes u akuzua se ishte hajdut dhe
13 bashkëpunonte me serbët. Çdo herë që viktima sillej në ahur,
14 torturuesit e tij urdhëronin të ndaluarit e tjerë që të
15 bërtisnin "Vdekje tradhtarëve, vdekje hajdutëve, vdekje
16 rrugaçëve dhe lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës". Në këto
17 kushte në një mjedis të egër që pjesëtarët e BIA-s në
18 udhëheqjen dhe komandës së Salih Mustafës, e nxorën viktimën e
19 vrasjes, dhe e trajtuan në kushte të tmerrshme.

20 Viktima e vrasjes ishte i vetmi i ndaluar duart e të
21 cilit ishin të lidhura dhe nuk kishte mundësi të ushqehet. U
22 rrah dhe nuk mund të qëndronte në këmbë, u dogj me hekur dhe u
23 ther me thikë. I gjithë badi [sipas përkthimit] i tij ishte i
24 zi nga goditjet, mavijosjet, fytyra e tij e ënjtur deri në
25 pikën që mezi hapte sytë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 71

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 Në kohën kur Dëshmitari 3593 arriti në ahur, ai pa
2 viktimën që nuk ishte në gjendje të qëndronte në këmbë dhe
3 mezi fliste. Viktima e vrasjes i tha atij dhe po citoj, "Do të
4 të vrasin". Edhe sot, Dëshmitari 4669 i rikujtohen dhe ka
5 makthe nga trajtimi i viktimës së vrasjes.

6 Dëshmitari 1679 i tha Trupi Gjykues, po citoj:

7 "Të gjithë prej nesh, të gjithë ne jemi rrahur, por ai
8 është masakruar."

9 Dëshmitari 1679 tha që mund t'i vinte era mishit të
10 viktimës së vrasjes dhe më e rëndësishme viktima e vrasjes,
11 atij iu mohua ndihma mjekësore që ai kishte kaq shumë nevojë
12 për të që mund t'i kishte shpëtuar jetën.

13 Më 19 prill 1999, [REDAKTUAR] pasi ai u çua nën
14 arrestin e Salih Mustafës, viktima e vrasjes ishte në gjendje
15 agonie. Në atë moment nuk ishte më në gjendje të qëndronte në
16 këmbë apo të ecte. Të gjithë të ndaluarit, të burgosurit e
17 tjerë në atë kohë u liruan, vetëm viktima e vrasjes dhe një i
18 ndaluar tjetër që ishin më të keqtrajtuar në mes të të
19 ndaluarve, qëndruan, u mbajtën në ndalim.

20 Disa ditë më vonë, Dëshmitari 4600 mori vesh [REDAKTUAR]
21 [REDAKTUAR] që viktima e vrasjes kishte vdekur. Kufoma
22 e viktimës së vrasjes u gjet më vonë atë vit në korrik 1999,
23 në një varr bosh, [REDAKTUAR]. Kufoma ishte në
24 gjendje të dekompozuar dhe mbante shenja të lëndimeve të rënda
25 në krahë dhe në këmbë, si dhe vrima plumbash në gjoks.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 72

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 Këto janë faktet, të nderuar Gjykatës, për të cilat ne
2 kërkojmë që t'i mbani parasysh në momentin kur të merrni, kur
3 të shqyrtoni parimet ligjore të ngritura në apel.

4 Tani kthehem tek çështjet ligjore.

5 Përpara se të trajtoj çështjet thelbësore të ngritura për
6 këto pika, dhe në veçanti pyetjet e parashtruar nga ju, të
7 nderuar, dua të theksoj se z. Mustafa nuk ka bazuar, provuar,
8 pikat, as në, për të përmbushur kriteret minimale të
9 standardit të kërkuar për hedhje poshtë të akuzave. Ne kemi
10 parashtruar, bërë parashtrime të hollësishme me shkrim për
11 mangësitë formale në apelin e z. Mustafa.

12 Parashtrimet e z. Mustafa në këto pika në dosjen e tyre
13 dhe sot pasdite, në të dy rastet, nuk kanë shtjelluar në
14 mënyrë të kuptimplotë pikat e artikuluar në Njoftimin për
15 Apel. Dhe Njoftimi për Apel ngre çështje që janë ngritur për
16 herë të parë në apel.

17 Kushtet formale, kriteret formale janë zhvilluar për një
18 arsye, janë krijuar për një arsye, kërkojnë që apeluesi të
19 identifikojë gabimet ligjore qartësisht dhe të shpjegojë
20 gabimet se si këto gabime zhvlerësojnë aktgjykimin. Kur
21 ngritën pretendime për gabime faktike, apeluesit duhet t'i
22 tregojë se Trupit, duhet të tregojë se vlerësimi i Trupit
23 Gjykues i provave është në tërësi i gabuar dhe se këto prova
24 nuk mund të ishin pranuar nga një vlerësues i fakteve i
25 arsyeshëm.

1 Vetëm një gabim i tillë që shkakton gabim gjyqësor
2 justifikon ndërhyrjen në apel. Asnjë nga parashtrimet e z.
3 Mustafa nuk përmbushin këto kritere. Në thelb, të nderuar, z.
4 Mustafa ju paraqet juve një bllok druri dhe ju kërkon juve që
5 të nxirrni një figurë nga kjo. Kjo nuk është modeli i mirë për
6 të bërë procedurën në apel.

7 Z. Mustafa nuk ka parashtruar bazat për pikat 3-5, as për
8 të përmbushur standardet minimale, dhe për rrjedhojë këto pika
9 duhet të refuzohen.

10 Tani kthehemi tek thelbi.

11 Ne i kemi trajtuar parashtrimet e z. Mustafa, për pikën 3
12 dhe 5 në dosjen tonë, dhe nuk dua që të përsërisim ato që janë
13 shkruar tashmë. Pra do të përgjigjem kryesisht përgjigjeve
14 tuaja dhe parashtrimeve të bëra sot pasdite.

15 Por, pika gjithëpërfshirëse që dua që do t'ju kërkoja
16 juve, të nderuar, të merrni parasysh kur të vlerësoni çështjet
17 e parimit abstrakt, janë që lidhen me elementin e lidhjes
18 shkak-pasojë që të mos humbasim në gjërat e pavërteta logjike.
19 Problemi kryesor i z. Mustafa, i parashtrimit të z. Mustafa,
20 lidhur me këto pika është që ato bazohen në baza fallso.
21 Kryesorja nga këto është: Mustafa nuk ka shkaktuar vdekjen
22 sepse edhe një, është një shkak tjetër që ka kontribuar
23 ashtu, përkatësisht mundësia që forcat serbe të kenë shtënë
24 plumba.

25 Për të vënë këtë në kontekst, Trupi Gjyqësor konstatoi se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 74

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 përfundimi më i mundshëm nga provat është se pjesëtarët e BIA-
2 s kanë qëlluar plumba në drejtim të viktimës së vrasjes
3 përpara se të largoheshin nga kompleksi i Zllashit. Kjo është
4 përfundimi më i mundshëm nga provat. Dhe nuk diskutohen se,
5 dhe nuk ka kundërshtim se elementet e lidhjes së shkakësisë
6 janë përmbushur.

7 Tani në gjykim penal, Gjykata duhet të vlerësojë fajësinë
8 e të akuzuarit përtej dyshimit të arsyeshëm. Dhe në rastin kur
9 është rrethanor, siç është ky rast, standardi i vërtetimit
10 përtej dyshimit të arsyeshëm thotë që Gjykata duhet të
11 sigurohet që deduktimi i nxjerrë nga Gjykata është i vetmi që
12 mund të dalë nga këto prova.

13 Dhe për këtë arsye Trupi Gjykues është, duhet të
14 vlerësojë nëse ka patur ndonjë mundësi të arsyeshme që
15 plumbat, që plagët e shkaktuara nga plumbat të jenë shkaktuar
16 nga forcat serbe në mes të prillit, gjatë ofensivës së
17 prillit. Kjo është një skenar klasik i *in dubio pro reo*.
18 Sepse, kishte dyshim të arsyeshëm për atribuimin e plumbave.
19 Trupi Gjykues vlerësoi se përgjegjësia penale e z. Mustafa për
20 supozimin se serbët forcat kanë qëlluar plumbat.

21 Trupi Gjykues konstatoi me të drejtë se edhe kur të
22 marrim parasysh versionin e ngjarjeve më në favor të të
23 akuzuarit, z. Mustafa, edhe në këtë rast z. Mustafa dhe
24 vartësit e tij të BIA-s kanë kontribuar në mënyrë thelbësore
25 në vdekjen e viktimës së vrasjes, dhe kjo është mbi bazën së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 75

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 pari: trajtimi i rëndë i shkaktuar kundër viktimës së vrasjes
2 nga vartësit e BIA-s të z. Mustafa; mohimi i ndihmës mjekësore
3 për viktimën; së treti, refuzimi që ta, ose të lirohet
4 viktimës së vrasjes bashkë me të ndaluarit e tjerë, ose që të
5 evakuohej me të plagosurit duke parë se ofensiva serbe po
6 përgatitej dhe do ndodhte.

7 Argumenti se ky shkak tjetër, mundësia që viktima e
8 vrasjes mund të jetë qëlluar nga forcat serbe, ky argument për
9 një shkak tjetër, argumenti që kjo e çliron z. Mustafa nga
10 përgjegjësia penale, bazohet në bazën fallso që kontributi i
11 të akuzuarit mund të jetë i vetmi shkak për vdekjen. Dhe --
12 kërkoj ndjesë.

13 Njëra prej vështirësive këtu është gjuha e zakonshme nuk
14 pasqyron kriteret e ligjit mbi këtë çështje. Përdorimi i
15 zakonshëm i fjalës "shkak" mund të thotë që veprimet e të
16 akuzuarit duhet të kenë qenë e vetmja, shkak kryesor i
17 rezultatit. Por nuk është kështu si është e përkufizuar lidhja
18 shkak-pasojë në ligj.

19 Trupi Gjykses me të drejtë përcaktoi standardin e
20 aplikueshëm ligjor për shkakësinë, dhe ai është që: Sjellja e
21 kryer nuk duhet të jetë detyrimsht e vetmja shkak i vdekjes
22 së viktimës, por duhet që minimalisht të kontribuojë në mënyrë
23 thelbësore për këtë. Dhe ky është testi korrekt. Kjo është
24 standardi dhe asgjë nga ajo që tha z. Von Bone sot pasdite nuk
25 e kundërshton këtë verifikim apo këtë standard të ligjit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 76

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 zakonor ndërkombëtar.

2 Dhe referenca këtu në aktgjykim është paragrafi 687. Dhe
3 ju keni pyetur, të nderuar Gjykatës, nëse ky është standardi i
4 saktë për shkakësinë, duke marrur parasysh kushtin e
5 domosdoshëm. Pika e parë që ne theksojmë këtu është që në
6 konstatimet e Trupit Gjykues kushtet *sine qua non* për
7 shkakësinë është i vërtetuar në mënyrë të padiskutueshme.

8 Ne duhet t'i shohim veprimet e z. Salih Mustafa dhe të
9 vartësve të tij, shohim se ato janë, nuk ndahen nga zinxhiri i
10 shkakësisë. Po të mos e kishin mbajtur atë të ndaluar në
11 kompleksin e Zllashit, viktimës së vrasjes, ai nuk do të
12 kishte përfunduar në një varr bosh [REDAKTUAR] --

13 Po të mos e kishin keqtrajtuar me qëllim, me synim të
14 vrasjes dhe të mos e kishin lënë në një gjendje pranë,
15 pothuajse pranë vdekjes, që nuk ishte në gjendje të lëvizte,
16 do të kishte qenë në gjendje të ecte në këmbë dhe të largohej
17 nga kompleksi i Zllashit, siç bënë të burgosurit e tjerë.

18 Sikur Salih Mustafa të kishte dhënë urdhrin që ai të
19 evakuohej, t'i jepej ndihma mjekësore, ai nuk do të ishte
20 gjetur i përfunduar i vdekur, dhe është gjetur me gjithë këto
21 shenjat e keqtrajtimit. Si edhe plagë të shkaktuara nga armë
22 zjarri.

23 Në fakt, Trupi Gjykues shprehimisht konstatoi se viktima
24 i vrasjes nuk do të kishte vdekur, por ka vdekur për shkak të
25 keqtrajtimit ekstrem të shkaktuar nga i akuzuari dhe vartësit

1 e tij të BIA-s. Dhe Trupi Gjykses konstatoi se ai duhet të
2 kishte shpëtuar po të ishte dhënë ndihmë mjekësore. Dhe
3 referenca në aktgjykim këtu është paragrafi 626.

4 Këto konstatime, të nderuar Gjykatës, janë më se të
5 arsyeshme lidhur me provat përpara Trupi Gjykses.

6 Tani, dikush mund të thojë si përgjigje, por kjo ka qenë
7 kohë lufte. Mund të kishte vdekur siç kanë vdekur shumë civilë
8 të tjerë që janë vrarë gjatë ofensivës serbe. Kjo është
9 saktësisht logjika vetëvrasëse që unë e përmenda më herët, që
10 është pa arsye, e palogjikshme.

11 Kur merren parasysh kushtësinë *qua non* për lidhjen shkak
12 pasojë, imagjinata duhet të jetë sa më e [E pakuptueshme]. Kjo
13 është arsyeja për të cilën në botë alternative duhet të jetë
14 identike me faktet e vetëpërcaktuara duke hequr veprimet e të
15 akuzuarit dhe të vartësve. Me fjalë të tjera, pra duhet të
16 bëjmë një zbritje dhe jo shtim.

17 Për të vënë këtë në perspektivë, për të bërë një
18 krahasim, Trupi Gjykses konstatoi se kishte, ishte një lidhje
19 racionale në prova që tregonte se forcat serbe kanë qëlluar në
20 drejtim të kompleksit të Zllashit. Nuk kanë spekuluar, por
21 kanë gjetur prova racionale në dëshmi. Dhe për këto arsye --
22 ne themi që nuk ka dallim në konstatimet e Trupit Gjykses se
23 lidhja shkak-pasojë në këtë rast është vërtetuar dhe
24 plotësuar.

25 Duke u kthyer tani te çështja më e gjerë -- kjo është

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 78

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 vendosur në jurisprudencën e TPNJ-së para më shumë se 20
2 vjetësh. Trupi Gjykues në rastin Celibici ka vlerësuar disa
3 sisteme të brendshme vendore ligjore për të arritur në këtë --
4 arsyeja, shkaku thelbësor, testi, verifikimi i shkakut
5 thelbësor, secili mund të -- kontributi thelbësor.

6 Standardi i kontributit thelbësor pastaj është zbatuar
7 nga TPNJ-ja Dhoma Gjykuese në rastin Kordic dhe Cerkez, Oric,
8 Kurperic [sipas përkthimit], dhe paragrafi 560; në Karadzic,
9 volumi I, paragrafi 446; në Popovic, paragrafin 788 [sipas
10 përkthimit]; në Djordjevic, Lukic and Lukic [sipas përkthimit]
11 paragrafi 899; në rigjykimin e Haradinajt paragrafin 427,
12 Tolimir dhe paragrafi 715; në Brdjanin dhe paragrafin 392
13 [sipas përkthimit] në Milutinovic, dhe paragrafi 137. Këto
14 janë të gjitha aktgjykimet.

15 Gjykata Speciale për Sierra Leonen ka ndjekur këtë
16 standard në paragrafin 689, ashtu siç e ka bërë edhe Gjykata
17 Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Duch, Rasti 001,
18 paragrafin 331. Kjo është gjithashtu pasqyrohet në komentarin
19 e Kryqit të Kuq në Gjenevë, në Konventat e Gjenevës që janë
20 përdorur përfshirë dhe në Gjykatën e Apelit në rastin Thaçi
21 dhe të tjerët si burim i interpretimit të ligjit zakonor
22 ndërkombëtar në rastin KSC-BC-2020-06 IA009/F0030, paragrafi
23 96, në një përbërje të Trupit, të panelit pak më ndryshe nga
24 sot.

25 I njëjti Panel konfirmoi se jurisprudenca e Tribunalëve

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 79

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 *ad hoc* ishte metoda më e përshtatshme për të bërë dallimin e
2 ekzistencës së ligjit zakonor ndërkombëtar sepse ato gjykojnë
3 krime të ngjashme dhe përafërsisht për të njëjtën periudhë
4 kohore. Dhe këto komente u bënë në kontekstin e, kontekstit e
5 Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët 3.

6 Standardi thelbësor i shkakut është gjithashtu koherent
7 edhe me gjetjet faktike në të paktën dy raste. Dy çështje ku
8 një i akuzuar u shpall fajtor si kryesi i drejtpërdrejtë i
9 vrasjes bazuar në kontributin e tij thelbësor si drejt, si
10 kryes i drejtpërdrejtë. Kjo, sepse për në kontribut thelbësor,
11 edhe pse kontributet e të tjerëve kanë patur efekt më të
12 drejtpërdrejtë se sa i tij.

13 Rasti i parë është TPNJ Dhoma e Apelit në rastin Limaq që
14 ka konfirmuar dënimin e Haradin Balas për vrasjen e nëntë të
15 burgosurve si kryesi i drejtpërdrejtë edhe pse nuk ka mundur
16 të vërtetohet që ai ka qëlluar dhe ka vrarë të nëntë të
17 burgosurit vetë.

18 Në mënyrë të ngjashme Dhoma, Trupi Gjykses në TPNJ
19 shpalli fajtor Milan Lukic për vrasje të pesë personave edhe
20 pse provat vërtetuan vetëm se ai kishte vrarë një prej pesë
21 viktimave.

22 Trupi Gjykses gjeti në TPNJ Lukic dhe Lukic paragrafin
23 908:

24 "...Roli dhe veprimet e Milan Lukic në ngjarje që kanë
25 çuar në vrasjet, në Sase dhe në veçanti në buzët e lumit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 80

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 përpara dhe gjatë vrasjeve, ishin të tilla që jo për praninë e
2 tij dhe drejtimet, përfshirë edhe lidhur me mënyrën në të
3 cilën personat do të vriteshin, vrasjet mund të kishin, nuk do
4 të kishin kryer, po të mos kishte qenë për këto pra.”

5 Në gjykimin Lukic, Tribunali, Gjykata, Trupi Gjykes u
6 mbështetet në gjetjet e TPNJ-së, Dhomës së Apelit të TPNJ-së
7 në çështjen Seromba dhe Gacumbitsi, të bëra në kontekstin e
8 gjenocidit. Dhe tha, konfirmoi:

9 “... një person i cili nuk ka kryer personalisht
10 fizikisht një krim, në këtë rast personi që nuk ka --
11 personalisht ka qëlluar një viktimë, me gjithë mund të jetë,
12 megjithatë të shpallet i përgjegjshëm për kryerjen e krimit të
13 vrasjes nëse ka prova se kryesi, veprimet e kryesit ishin të
14 tilla që, po pjesë e tërësishme e vrasjes.”

15 Dhoma e Apelit në Lukic konstatoi në precedentin për [E
16 pakuptueshme] në rastin Limaj, ka konfirmuar dënimin,
17 shpalljen fajtor të Lukic si kryesi i drejtpërdrejt i vrasjes
18 dhe jo si bashkëkryes i [E pakuptueshme]. [Nuk ka Përkthim].

19 Përveç këtyre precedentëve ka edhe shembuj të shumtë të
20 jurisprudencës në lidhje me standardin e kontributit thelbësor
21 në kontekst të ndihmës dhe inkurajimit. Këtë e kemi paraqitur
22 në paragrafët 151 deri në 60 të dosjes sonë të apelit. Nuk kam
23 ndërmend t’i përsëris këto parashtrime, por thjesht këto mund
24 t’ju ndihmojnë.

25 Të nderuar Gjykatës, që të keni një ide të prekshme në

1 lidhje me atë që çka do të thotë standardi i shkakut thelbësor
2 në kontekst të një çështje të krimeve të luftës. Veçanërisht
3 ju tërheq vërejtjen për rastin apo çështjen gjyqësore Mrksic
4 dhe Sljivancanin, ku të akuzuarit i tërhoqën rojet e armatës
5 popullore të Jugosllavisë dhe kjo i la të burgosurit që nuk
6 ishin serbë të eksponuar ndaj forcave paramilitare serbe që po
7 afroheshin. Dhe në këtë mënyrë, ato ishin në gjendje t'i
8 sulmonin këta të burgosur. Në atë çështje, u konstatua se i
9 akuzuari me anë të këtij veprimi kontribuoi në mënyrë të
10 qenësishme në vrasjen e atyre të burgosurve.

11 Indikativ është edhe vendimi në çështjen Popovic. I
12 akuzuari nuk e kreu detyrën e vet ligjore për të mbrojtur të
13 burgosurit, që kontribuoi qenësisht në vrasjen që pasoi.

14 Gjithashtu edhe në rastin Krnojelac kemi shembullin ku u
15 vërtetua përgjegjësia komanduese për vrasjet apo vdekjet që u
16 kryen në qendrën e ndalimit nën komandën e tij.

17 Dhe këto të gjitha, në kuadër të formës së përgjegjësisë
18 përmes ndihmës dhe inkurajimit.

19 Dhe këto ilustrojnë arsyeshmërinë e përfundimeve të
20 Trupit Gjykues.

21 Tani do t'ju referohem edhe jurisprudencave vendore në
22 lidhje me këtë çështje. Në shumicën e rasteve është përdorur
23 dhe një standard edhe më i lartë i shkakut thelbësor se në
24 juridiksione ndërkombëtare, për shembull në qoftë se bëni një
25 analizë të vendimit të Trupit Gjykues në TPNJ në rastin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 82

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 Celibici. Në disa juridiksione mund të zbatohet standardi i
2 shkakësisë pa ndonjë standard shtesë. Si, për shembull,
3 standardi i atribuimit.

4 Mirëpo në juridiksionet e tjera, ka dhe standarde të
5 tjera si *sine qua non* dhe ato juridiksione shtojnë edhe
6 kritere ligjore shtesë për vërtetimin e kriterit të
7 shkakësisë, dhe qëllimi i këtyre kritereve shtesë është që të
8 vendosen disa kufizime ligjore të cilat ndryshe mund të
9 shkaktojnë dëm.

10 Për shembull, mendohet që një gjyshe nuk mund të
11 konsiderohet t'i ketë shkaktuar vdekjen nipit apo mbesës së
12 vet edhe pse provokimi prej saj ishte një kusht thelbësor për
13 vrasjen.

14 Tani në të drejtën anglosaksone ky kriter ligjor merr
15 formën e shkakut thelbësor. Në jurisprudencat vendore për
16 mendimin tonë, shkak thelbësor, ky kriter pra, në krahasim me
17 juridiksionet vendore është një kriter i domosdoshëm. Në
18 Shtetet e Bashkuara, shkakësia vërtetohet kur vdekja ishte një
19 pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e sjelljes së të
20 akuzuarit.

21 Në Kanada, për shembull, kemi rastin e Gjykatës Supreme
22 të Kanadasë, në çështjen *Smithens* [sipas përkthimit] që është
23 [1978] 1 S.C.R. dhe gjykata në paragrafin 518, deri në 522,
24 gjykoi se "lidhja shkakësore duhet të ishte ma shumë se
25 minimale". I njëjti standard u zbatua edhe nga Gjykata e

1 Mbretërisë së Bashkuar si dhe në Irlandë nga Gjykata Supreme e
2 Irlandës në një rast të një personi kundër Prokurorisë
3 Publike, janë paragrafët 67, në faqet 2015, 2016 [sipas
4 përkthimit].

5 Është interesante që i njëjti standard u pranua në
6 vendimin e ndarë të Gjykatës Eboe-Osuji në apelin Bemba.

7 Burime të tjera ligjore tregojnë për zbatimin e
8 standardit të kontributit të qenësishëm, ose të
9 konsiderueshëm. Këto janë rastet *R v. Pagett*. Është një rast
10 në gjykatën e Apelit të Anglisë dhe Uellsit, Crim 627,
11 paragrafi 23, është referenca.

12 Ka edhe gjykata të tjera nga juridiksionet anglo-
13 amerikane ku zbatohet kriteri i shkakut thelbësor veprues.
14 Kemi një vendim të Gjykatës së Apelit Q.B. 35, simbas kësaj
15 gjykate u hodh poshtë propozimi i apeluesit se kontributi
16 duhet të jetë i vetmi shkak i vdekjes. Dhe se kontributi duhet
17 të jetë shkak i drejtpërdrejtë i vdekjes. Dhe ky është i
18 njëjti mendim që ndan edhe një gjykatë tjetër në çështjen
19 Smith. Kështu që parashtrimet e z. Von Bone sot pasdite nuk
20 përputhen të paktën me këto burime ligjore nga e drejta
21 anglosaksone që i citova.

22 Dhe kjo është, ky është, edhe mendimi i Shërbimit të
23 Prokurorisë së Mbretëreshës së Anglisë dhe Uellsit në
24 udhëzimet për prokurorinë.

25 Mbretëresha kundër Smith është ndjekur si çështje në disa

1 juridiksione. Në Zelandën e Re, në Fixhi, në Hong-Kong, në
2 Nauru, dhe në Sri-Lankë dhe kështu me radhë. Mund t'ju jap
3 referencat me shkrim në qoftë se është kjo për interes për ju,
4 të nderuar Gjykatës.

5 Në Gjykatën e Apelit të Australisë gjithashtu është
6 ndjekur e njëjta jurisprudencë, domethënë, kriteri i shkakut
7 thelbësor. Në një rast, i akuzuari e kishte lënë viktimën pa
8 vetëdije në një plazh në fund të ujit. Viktima vdiq nga fakti
9 që ishte pa vetëdije dhe si rezultat i baticës dhe zbaticës.
10 Viktima ishte pa vetëdije, por veprimet e të akuzuarit ishin
11 të rëndësisë thelbësore për shkaktimin e vdekjes.

12 Dallimi kryesor midis kësaj dhe çështjes në fjalë është
13 se viktima e vrasjes do të kishte vdekur pavarësisht nga një
14 faktor i ri ndërhyrës. Dhe kësaj do t'i kthehem më me hollësi
15 më vonë.

16 Ka edhe burime të tjera ligjore nga jurisprudencat e të
17 drejtës anglosaksone që lidhen me standardin e
18 parashikueshmërisë së arsyeshme. Dhe këto shembuj janë zbatuar
19 nga gjykata të ndryshme përfshirë Gjykatën e Lartë të
20 Australisë. Pra këto janë shembujt nga e drejta anglosaksone.

21 Dhe kjo jurisprudencë vërteton se standardi i shkakut
22 thelbësor simbas të drejtës anglosaksone të paktën është
23 standard më i lartë se ai i atribuimit.

24 Sa u përket disa vendimeve të marra nga gjykatat në
25 Gjermani, ato kryesisht zbatojnë përveç kushtit *sine qua non*,

1 edhe teorinë e transaksionit normativ kur një rrezik ekzistues
2 materializohet.

3 Sipas Dhomës së Apelit të Tribunalit Penal për ish-
4 Jugosllavi në rastin Celibici, Belgjika dhe Norvegjia kërkojnë
5 të ashtuquajturin kusht të shkakësisë adekuate.

6 Këto janë shembuj që ilustrojnë se standardi i shkakut
7 thelbësor në të drejtën zakonore ndërkombëtare konsiderohet si
8 standardi më i lartë.

9 Dhe në qoftë se ju, të nderuar Gjykatës, do ta
10 zëvendësonit këtë test apo këtë standard me ndonjë standard
11 tjetër të shkakësisë, kjo nuk do të ndryshonte konstatimet e
12 Trupit Gjykues se i akuzuari, z. Mustafa, dhe vartësit e tij
13 të BIA-s ligjërisht, nga aspekti ligjor, shkaktuan vdekjen e
14 viktimës së vrasjes dhe se vdekja e viktimës iu atribuohet
15 atyre.

16 Në fakt, z. Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s bënë çdo
17 gjë të nevojshme për të vrarë viktimën e vrasjes. Pasi që i
18 kishin shkaktuar lëndime të rënda e lanë viktimën e vrasjes në
19 gjendje pothuajse të vdekur dhe të pamundur në rrezik të
20 drejtpërdrejtë.

21 Versioni i ngjarjeve më në favor të z. Mustafa është ai
22 që viktima e vrasjes i mbijetoi lëndimit vdekjeprurës dhe më
23 në fund u vra nga forcat serbe. Por, edhe në këtë version të
24 ngjarjeve, këto lëndime në kombinim me refuzimin e z. Mustafa
25 që ta lironte apo evakuonte viktimën e vrasjes apo që t'i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 86

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 ofronte atij ndihmë mjekësore, pra edhe sikur të merret
2 parasysh versioni më i favorshëm i ngjarjeve për z. Mustafa,
3 përfundimi është se veprimet e z. Mustafa dhe të vartësve të
4 tij në BIA ndikuan në mënyrë të qenësishme në vdekjen e
5 viktimës së vrasjes. Me kombinimin e të gjithë këtyre
6 faktorëve, ata ia mohuan viktimës mundësinë e fundit për të
7 mbijetuar.

8 Këto fakte në fakt përmbushin të gjitha standardet
9 ligjore të nevojshme. Për shembull, vdekja e viktimës së
10 vrasjes ishte pasojë e mundshme që mund, në mënyrë të
11 arsyeshme, të ishte marrë parasysh kontributi i z. Mustafa dhe
12 i vartësve të tij në BIA, ishte më shumë se minimal. Ishte
13 thelbësor, i konsiderueshëm. Ishte veprues, operativ. Dhe çdo
14 person i arsyeshëm në pozitë të z. Mustafa nuk do të mund të
15 mos e kishte parashikuar vdekjen si pasojë për viktimën e
16 vrasjes.

17 Ata vetë e shkaktuan rrezikun e vdekjes dhe ajo vdekje u
18 materializua, u realizua. Ata e shkaktuan këtë vdekje nga
19 aspekti faktik ligjor dhe moral. E vetmja pyetje që mund të
20 ketë mbetur e pazgjidhur ishte se si viktima e vrasjes mund të
21 kishte vdekur apo do të vdiste. Mirëpo, kjo pyetje nuk është
22 materiale apo e rëndësishme për përgjegjësinë penale të z.
23 Mustafa.

24 Tani, do të flas për ngjarjet e reja ndërhyrëse në
25 kontekstin e standardit të shkakësisë për veprën penale të

1 vrasjes. Fillimisht dua të theksoj se është me rëndësi që të
2 bëhet një dallim midis parimit të ngritur në Dosjen e Apelit
3 të z. Mustafa dhe që u përmend në parashtrimet gojore sot nga
4 z. Von Bone. Mirëpo, aty nuk bëhet dallim midis konceptit të
5 dallueshëm të shkakësisë sipas të drejtës ndërkombëtare
6 zakonore dhe si ai koncept lidhet me ngjarjet e reja
7 ndërhyrëse.

8 Aspekti kryesor i këtij parimi është se veprimi kriminal
9 vullnetar i një personi të tretë e ndërprejnë atë zinxhir të
10 shkakësisë, kur për shembull kontributi i të akuzuarit është i
11 parashikueshëm dhe mbetet thelbësor dhe veprues në kohën e
12 vdekjes vetëm veprimet vullnetare dhe të vetëdijshme të një
13 personi të tretë mund ta lirojnë atë nga përgjegjësia penale.
14 Për të gjitha arsyet të tjera të reja intervenuese, vazhdon të
15 zbatohet apo është i zbatueshëm parimi i shkakësisë.

16 Në rastin *R v. Pagett* i akuzuari kishte përdorur të
17 vdekurit si mburojë të gjallë dhe i vdekuri pastaj ishte
18 qëlluar nga policia. Pra, edhe pse i akuzuari apo veprimet e
19 të akuzuarit ishin vetëm një shkak jo i drejtpërdrejtë i
20 vdekjes, ai përsëri u shpall fajtor për atë rast.

21 Edhe në sistemet e të drejtës anglosaksone, nuk zbatohet
22 çdokund njësoj ky parim. E njëjta gjë është e vërtetë edhe në
23 çështjen *Smithers* që e përmenda edhe më herët në faqen 521,
24 dhe po gjithashtu edhe në çështjen *Mbretëresha kundër*
25 *Wolfgaffers* [sipas përkthimit], *Dagwoburts* [sipas përkthimit]

1 e 2006, EWCA 627, referenca për të cilën e kam fjalën këtu
2 është paragrafi 21.

3 Duke marrë parasysh kohën po e kaloj më shpejt
4 prezantimin e parashikuar se sa mendova paraprakisht se do
5 merrja.

6 Ky është proces apeli, dhe barra për të përcaktuar se
7 parimi i ndërhyrjes së re është pjesë e të drejtës
8 ndërkombëtar zakonore është përgjegjësi e Mbrojtjes, dhe z.
9 Mustafa nuk ka dhënë asnjë burim të besueshëm që e demonstroi
10 këtë qëndrim. Z. Mustafa nuk ka etiketuar apo nuk ka
11 identifikuar asnjë burim me autoritet të tribunalëve *ad hoc*
12 siç parashikohet në nenin 3 të ligjit.

13 Ai madje as nuk ka mbështetur shkaqet për apelim të
14 çështjes me citime është vijë nga e drejta ndërkombëtare, nga
15 çështje që kanë të bëjnë me të drejtën ndërkombëtare penale.

16 Edhe për arsye argumenti dhe në qoftë se do ta pranojmë
17 që aplikohet parimi i ndërhyrjes së re në sistemin
18 anglosakson, anglo-amerikan, kjo në vetvete nuk është e
19 mjaftueshme për të thënë që ky është një parim që është i
20 zbatuar në të gjithë të drejtën ndërkombëtare zakonore. Është
21 një standard i qartë që përfshin proceset penale të brendshme
22 në të drejtën ndërkombëtare penale, dhe pragu është që
23 rregulli duhet që të lidhet me sistemet ligjore të botës dhe
24 siç është bërë qartë në çështjen e TPNJ-së, çështjen kundër
25 Celebici, në paragrafin 414 dhe 431.

1 Po ashtu, edhe Dhomat e Apelit të TPNJ-së në çështjen
2 Sainovic, kanë bërë të njëjtat komente në aktakuzën, në
3 vendimin, aktgjykimin e apelit në paragrafin 1643.

4 Edhe Gjykatësi Ambos bëri gjithashtu një koment të
5 ngjashëm kur iu referua traktateve dhe të drejtës
6 ndërkombëtare penale në volumnin 1 në faqen 77.

7 Është ngritur shumë herë kjo çështje që për të izoluar
8 një koncept, një koncept të brendshëm nga rendi juridik i vet,
9 një rend juridik që është zhvilluar në mënyrë organike, dhe të
10 importosh një ligj drejtpërsëdrejti nga e drejta ndërkombëtare
11 penale, është juridikisht e gabuar, si sipërmarrje.

12 Juridiksionet e brendshme zbatojnë konceptet e tyre të
13 përgjegjësisë penale, mbështetur në vlerat e veta në parimet e
14 veta dhe këto jo gjithmonë janë të ndara apo janë të njëjta në
15 nivelin universal. Dhe kjo është arsyeja pse standardi i
16 rregullave, i inkorporimit ose i përfshirjes së rregullave të
17 brendshme në të drejtën ndërkombëtare zakonore është një
18 standard shumë i lartë.

19 Në parashtrimet tona, z. Mustafa nuk ka arritur që të
20 vërtetojë që ky parim është pjesë e të drejtës ndërkombëtare
21 penale, të drejtës ndërkombëtare zakonore.

22 Edhe një herë do të doja që të theksoja rreziqet të cilat
23 lidhen me marrjen e rregullave të cilat janë të zbatueshme në
24 një sistem juridik të caktuar në veçanti në rrethanat e një
25 çështjeje të ngjashme si kjo.

1 Tani, duke iu përgjigjur pyetjeve që keni bërë ju, të
2 nderuar Gjykatës, do të japim disa shembuj dhe kjo është
3 mënyra se si kuptojmë ne jurisprudencën në vendet përkatëse
4 lidhur që do të citohen.

5 Por, e njëjta logjikë aplikohet edhe në çështjen në
6 fjalë.

7 Për shembull, në rastin e Spanjës një veprim i ri mund në
8 mënyrë përjashtimore të shkëpusë zinxhirin e shkakësisë. E
9 njëjta gjë vlen edhe për Italinë, ku zinxhiri i shkakësisë
10 shkëputet vetëm nga shkaqe tërësisht të pavarura të cilat
11 krijojnë një zinxhir shkakësie që janë të mëvetësishme,
12 autonome, të veçanta nga ato që përcaktohen nga të akuzuarit,
13 ose ato që karakterizohen nga anomali absolute dhe
14 përjashtimore edhe që shkojnë përtej fushës së
15 parashikueshmërisë normale, të arsyeshme dhe si të tilla janë
16 të paparashikueshme.

17 Në rastin e Gjermanisë, në përgjithësi, një ngjarje
18 ndërhyrëse vetëm thyen zinxhirin e shkakësisë në qoftë se ajo
19 ndodh jashtë përvojës jetësore, dhe këtui, të nderuar Gjykatës,
20 duhet që t'i referohem vendimit të gjykatës gjermane më datë 3
21 korrik 1959, për referencë është dokumenti 4 StR 196/59,
22 paragrafi 7.

23 Edhe citoj:

24 "Megjithatë, nuk mund të flitet për një rezultat të
25 parashikueshëm në qoftë se rrjedha e ngjarjeve në fund është

1 ajo çfarë mund të parashikohet, siç ka ndodhur në këtë rast
2 individual. Por në fakt mjafton që rezultati përfundimtar të
3 jetë i parashikueshëm. Nga ana tjetër, në qoftë se rrjedha e
4 ngjarjeve është përtej përvojës jetësore që kryesi mund të mos
5 e ketë parashikuar atë, edhe në qoftë se do ishte marrë me
6 kujdes parasysh rrethanat e çështjes, dhe që mund të priteshin
7 prej tij apo për sa i takon nevojave jetike dhe aftësive dhe
8 njohurive të tij për jetën, në këtë rast ai nuk mban
9 përgjegjësi penale.”

10 Pra kjo është mënyra se si gjykata të ndryshme kanë
11 trajtuar shkaqet ndërhyrëse dhe ngjarjet ndërhyrëse. Në këto
12 dy raste të fundit, parashikohen që këto parime, të paktën në
13 Gjermani nuk ndryshojnë në rastin e akteve nga persona
14 vullnetarë ose akte kriminale ose akte të palëve të treta,
15 domethënë, i njëjti parim zbatohet dhe këtu.

16 Ndërkohë një tjetër vendim është ai i një gjykate tjetër
17 gjermane, është vendim i datës 30 gusht 2020, dokumenti 2 StR
18 204/00. Faktet mund të përmbliidhen në mënyrë të shkurtër.

19 Faktet janë si më poshtë:

20 I akuzuari kishte qëlluar me thikë personin e vdekur disa
21 herë përfshirë edhe në fytyrën e tij dhe e kishte lënë atë të
22 vdiste me thikën që e kishte të ngulur në fytyrën e personit
23 të vdekur. I akuzuari ishte kthyer në shtëpi dhe i kishte
24 treguar të dashurit të saj se çfarë kishte ndodhur dhe që e
25 kishte goditur me thikë dhe kishte vdekur personi përkatës. Të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 92

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 dy ata më pas u kthyen në skenën e krimit në mënyrë që të
2 zhduknin provat. Por në momentin kur ata shkuan atje, panë që
3 i vdekuri, viktimë, ishte ende gjallë. Dhe çfarë bënë, është
4 që hoqën thikën nga fytyra e tij dhe e goditën viktimën me një
5 shishe uji duke i thyer një prej kockave të fytyrës.

6 Ndërkohë që gjykata në faqen 4 thuhet si më poshtë:

7 "Devijimet nga fluksi, apo nga rrjedha e prezumuar e
8 shkakësisë janë ligjërisht jo domethënëse, çfarë do të thotë
9 që ka akoma, çfarë do të thotë që gjithsesi të akuzuarit
10 mbajnë përgjegjësi për atë çfarë ka bërë."

11 Dhe në faqen 6 parashikohet që:

12 "Akti i kryesit vazhdon që të jetë shkakësor edhe në
13 qoftë se një palë e tretë më pas vepron në mënyrë të
14 qëllimshme duke kontribuar apo duke çuar në rezultat të
15 njëjtë duke u mbështetur në faktin që personi tjetër, pra
16 personi i tretë i vazhdon më tej veprimet e nisura nga kryesi
17 fillestar..."

18 Dhe po ashtu, e njëjta gjë është identifikuar edhe nga
19 Gjykata Federale Gjermane. Bëhet fjalë për një çështje që ka
20 të bëjë me një mosmarrëveshje dhe me një zënkë ndërmjet një
21 grupi të rinjsh. I akuzuari identifikohet si personi "K" i
22 cili goditet me grusht dhe që lihet në gjendje shoku për një
23 periudhë të gjatë kohe. Ndërkohë që një person tjetër afrohet
24 afër viktimës dhe godet edhe më tepër në kokë me tre grushta
25 të tjera. Në këtë moment viktimë e humb toruan, e humb

1 ndërgjegjen edhe në vend që të marrë frymë merr, domethënë
2 merr frymë gjakun e tij që ishte shkaktuar nga një fraksion në
3 fytyrë.

4 Gjykata tha që elementet e shkakësisë dhe të atribuimit
5 janë përmbushur sepse i akuzuari e dëmtoi dhe e dobësoi
6 viktimën dhe e bëri atë të paaftë që të mbrohej ndaj goditjes
7 së një personi tjetër. Kështu që i akuzuari duhet të kishte
8 parashikuar që viktima kishte aftësi të kufizuar për të
9 mbrojtur veten, e cila në vetvete ishte rezultat i grushteve
10 që kishte pësuar nga i akuzuari.

11 Dhe mund të çonte në vazhdimësinë dhe në rritjen e
12 ashpërsisë së veprimeve të cilat u shkaktuan nga personi i
13 tretë.

14 Në qoftë se do më lejoni një çast, të nderuar Gjykatës.

15 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

16 Z. BAARLINK: [Përkthim] Sa i takon Kosovës, çështja
17 gjyqësore kundër Agron Zeqirit ka të bëjë me akuza të ndalimit
18 të paligjshëm që kanë çuar në vdekje. Nuk kemi të bëjmë me
19 akuzë vrasjeje, e kuptojmë këtë gjë. Megjithatë, mbështetur në
20 nenin 63 të ligjit penal të Republikës së Serbisë, pra, dhe
21 ligji 63.5, domethënë së pari nën nenin 63 kemi ndalimin e
22 paligjshëm dhe nenin 63/5 kemi ndalim që çon në vdekje.

23 Gjykata Supreme e Kosovës tha që do të ketë një
24 marrëdhënie shkak-pasojë ndërmjet aktit të ndalimit të
25 paligjshëm dhe pasojave vdekjeprurëse për viktimën. Duke vënë

1 re probabilitetin e situatave të tilla gjatë konflikteve të
2 armatosura ose trazirave sociale, gjykata vazhdoi duke thënë,
3 dhe për referencë është aktgjykimi i datës 17 tetor 2006,
4 faqja 6, pra është çështja kundër z. Zeqiri. Gjykata shprehet
5 si më poshtë që:

6 "Përgjegjësia për ndalimin që çon në vdekje mund të
7 atribuohet në kushtet në të cilat ndodh lirimi. Kjo do të
8 thotë që viktima në vend që të kthehet në një situatë të
9 sigurt, lirohet në një mjedis që përbën kërcënim për jetën e
10 tij ose të saj, për shembull lihet ndërmjet dhunës së
11 armatosur ose territorit armik ose në kushte të cilat janë
12 ekstreme, pra kushte moti që janë ekstreme, ose lihet në vende
13 që janë shumë larg vendit të tij të banimit."

14 Gjykata Supreme më tej sqaroi se kur viktima e ndalimit
15 të paligjshëm gjendet i vrarë, përgjegjësia për vdekjen mund
16 t'i atribuohet personit që janë përgjegjës për ndalimin e tij
17 në qoftë se ndalimi ose kushtet e lirit dhanë një mundësi
18 për palën e tretë që të kryenin vrasjen, me kusht që të ketë
19 një lidhje shkakësore dhe aplikimi i parimit *mens rea* sa i
20 takon personave që janë përgjegjës për ndalimin.

21 Dhe në këtë çështje, në fund, pra në çështjen Zeqiri,
22 Gjykata Supreme e Kosovës konfirmoi fajësinë e të akuzuarit
23 duke konstatuar që nuk ishin vërtetuar shkakësia dhe synimi në
24 veçanti përderisa akuzat dhe dëshmitë e paraqitura
25 përshkruanin vetëm arrestimin dhe zbulimin e trupit të

1 viktimës.

2 Më tej gjykata vlerësoi se "në asnjë kohë, në asnjë pikë
3 kohore, gjatë gjykimit në shkallë të parë, prokuroria nuk u
4 përpoq që të artikulonte elementët faktikë të cilët do të
5 kishin demonstruar një lidhje shkakësore ndërmjet ndalimit të
6 viktimës dhe vrasjes së tij". I akuzuari z. Mustafa ishte
7 dëshmitar në çështjen Zeqiri, që kishte të bënte gjithashtu
8 edhe me krimet e pretenduara të kryera nga anëtarët e BIA-s.

9 Megjithatë, ndryshe nga çështja Zeqiri, krimet e akuzuara
10 në çështjen në fjalë janë provuar përtej dyshimit të
11 arsyeshëm. Përfshirë këtu edhe vrasjen që minimalisht ka çuar
12 në rrethana që kanë çuar në drejtimin vdekjeprurës të
13 viktimës, dhe ndalimin dhe lirimin e tij që më pas kanë çuar
14 në vdekjen e viktimës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Thjesht për
16 t'ju treguar se keni kohë deri në orën 17.20.

17 Z. BAARLINK: [Përkthim] Faleminderit për njoftimin.

18 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

19 Z. BAARLINK: [Përkthim] Arsyeja që pse i përmend të
20 gjitha këto çështje është që për të theksuar dhe një herë
21 tjetër se parimi i ndërhyrjes së akteve të reja që u ngrit nga
22 Mbrojtja e z. Mustafa, nuk është e drejta ndërkombëtare
23 zakonore dhe z. Mustafa nuk e ka vërtetuar këtë gjë dhe nuk ka
24 bërë përpjekje të njëmendtë për ta vërtetuar këtë gjë. Dhe,
25 përmes jurisprudencës ne ju bëjmë të qartë disa nga parimet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 96

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 kryesore të cilat zbatohen në nivelin botëror, pra
2 universalisht. Dhe në rastin e parimeve të zakonshme të
3 shkakësisë këto parime zbatohen edhe në rastet kur ka një
4 ndërhyrje, apo ka një ngjarje ndërhyrëse.

5 Kështu që, të nderuar Gjykatës, nuk është e nevojshme për
6 juve që të shkoni më tej, por përveçse të merrni parasysh
7 shpjegimin që ne dhanë dhe gjithashtu edhe të merrni parasysh
8 të drejtën ndërkombëtare zakonore. Të gjitha këto parime të
9 çojnë vetëm në një përfundim, që është që z. Mustafa dhe
10 vartësit e tij në njësitin BIA kanë kontribuar për vdekjen e
11 viktimës së vrasjes.

12 E di, të nderuar Gjykatës, që ju nuk keni bërë asnjë
13 pyetje sa i takon përgjegjësisë për mosveprimin. Ne kemi bërë
14 parashtrime lidhur me këtë gjë, por përderisa nuk kemi shumë
15 kohë nuk synojmë që ta trajtojmë këtë çështje këtu.
16 Megjithatë, do ju kërkoja, të nderuar Gjykatës, që t'i hidhnit
17 një sy dhe të lexonit parashtrimet tona lidhur me
18 përgjegjësinë për mosveprimet.

19 Duam që të jap një përgjigje komentit të z. Von Bone sot
20 pasdite lidhur me vrasjen.

21 Pika një, parashtrimet lidhur me kohën e vdekjes.
22 Sigurisht që koha e vdekjes nuk është një element i krimit të
23 vrasjes edhe as vendi i vdekjes nuk është pjesa e elementit të
24 krimit të vrasjes. Arsyeya e vetme është periudha e aktakuzës.
25 Dhe Trupi Gjykues në fakt konstatoi në mënyrë të arsyeshme që

1 vdekja ka ndodhur gjatë periudhës së aktakuzës. Kjo mbështetet
2 në faktin që viktima e vrasjes herën e fundit që është parë i
3 gjallë ishte thujse në prag vdekje. Dhe kjo në fakt jepet në
4 aktgjykimin e Trupit Gjykues në faqen 621. Thuhet që kur u
5 zhvarros trupi, ai ishte duke u kalbëzuar, dekompozuar. Kjo
6 jepet në faqen 614 të aktgjykimit. Po ashtu në mënyrë të
7 rëndësishme dëshmitari 4600 vetëm disa ditë pas ofensivës
8 serbe që ka ndodhur vetëm disa ditë përpara fundit të prillit,
9 i është thënë këtij personi [REDAKTUAR]
10 [REDAKTUAR] që viktima e vrasjes kishte vdekur në atë kohë.

11 Ne parashtrojmë se konstatimet e Trupit Gjykues lidhur me
12 këtë pikë janë të arsyeshme dhe sigurisht që kriteri për
13 rishikim nuk është përmbushur për ta kundërshtuar këtë
14 konstatim.

15 Sa i takon disponueshmërinë e trajtimit mjekësor, Trupi
16 Gjykues në paragrafin 621 në poshtëshënimin 1346, përcakton se
17 trajtimi mjekësor në përgjithësi ka qenë i disponueshëm ose i
18 është vënë në dispozicion personave që kanë qenë në kompleksin
19 e ndalimit në Zllash ndryshe nga parashtrimet që bëri z. Von
20 Bone sot.

21 Sa i takon testit të shkakut thelbësor, z. Von Bone nuk
22 duket sikur kundërshton saktësinë e standardit juridik, por
23 zbatimin e tij nga Trupi Gjykues. Sigurisht, që kjo ka të bëjë
24 me fakte, është çështje fakti. Kështu që standardi përkatës i
25 rishikimit për gabime fakti zbatohen këtu. Kështu që ne

1 parashtrojmë që ky është standardi që duhet të shikohet dhe të
2 përmbushet dhe ky është një parashtrim dhe një standard i cili
3 nuk është përmbushur nga Mbrojtja.

4 Sa i takon ngjarjeve ndërhyrëse, z. Von Bone, tha disa
5 herë që Trupi Gjykses nuk ka shqyrtuar skenarë apo hipoteza
6 alternative, kur në fakt Trupi Gjykses ka shqyrtuar vetëm
7 aftësinë e mundshme të arsyeshme, mundësinë e arsyeshme të
8 vetme, që mund të jetë gjuajtur me plumba në drejtim të
9 viktimës nga forcat serbe. Dhe në këtë rast edhe në këtë
10 skenar, Trupi Gjykses arsyetoi se i akuzuari prapë mbante
11 përgjegjësi penale edhe në qoftë se do të kishte ndodhur kjo.

12 Po ashtu shkurtimisht u përmend aktgjykimi i Tadic, në
13 paragrafin 240. Ky është një konstatim faktik i një Trupi
14 Gjykses. Sigurisht që çdo çështje gjyqësore ka faktet e veta.
15 Sigurisht që çështjet mund të jenë të dallueshme, të ndryshme
16 nga njëra-tjetra për shumë faktorë, por edhe në atë rast asnjë
17 nga të burgosurit nuk është parë asnjëherë. Por nuk kishte
18 konstatim se ndonjë prej të burgosurve do të kishte vdekur
19 pavarësisht ndërhyrjeve të tjera, ngjarjeve të tjera
20 ndërhyrëse. Dhe një argument tjetër i përgjithshëm është që
21 konstatimet faktike të një Trupi Gjykses nuk janë detyruese
22 për çështje faktike për një trup tjetër Gjykses apo një lëndë
23 tjetër gjyqësore e cila mbështetet në fakte tërësisht të
24 ndryshme dhe pa diskutim që nuk vërteton që përfundimet e
25 Trupit Gjykses nuk janë të arsyeshme. Dhe që asnjë trup

1 Gjykues i arsyeshëm do të kishte arritur në këtë përfundim.

2 Tani shkurtimisht më lejoni që të trajtoj format e
3 përgjegjësisë penale. Z. Mustafa po ashtu akuzohet për
4 përgjegjësi ndihmuese dhe inkurajuese. Në parashtrimet tona ai
5 duhet të jetë përgjegjës edhe për këtë pikë. Elementët e
6 ndihmës dhe inkurajimit janë të përcaktuara mirë, përfshirë
7 këtu edhe nga gjykimi i apelit të Sainovic, në çështjen
8 Sainovic. *Actus reus* për sa i takon ndihmës edhe inkurajimit
9 përbëhet nga ndihma praktike, inkurajimi, nga mbështetja
10 morale të cilat kanë një ndikim thelbësor mbi kryerjen e
11 krimit.

12 Por ashtu kjo ka të bëjë me mosveprimin dhe me
13 vetëdijësinë për elementët thelbësorë të këtij krimi dhe të
14 cilat vihen në lëvizje me synimin dhe që janë synime të
15 kryesve. Nuk është e nevojshme pra që -- nxitësi dhe ndihmuesi
16 të dinë ekzaktësisht krimin që synojnë që të kryhet, por
17 mjafton që ata thjesht të mund të kenë ndihmuar ose
18 inkurajuar.

19 Dhe kjo në fakt jepet e shpjeguar edhe në gjykimin e
20 apelit Sainovic në paragrafin 1626, 1772, 1773.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Keni vetëm
22 pak minuta në dispozicion, sa për t'ju njoftuar, z. Prokuror.

23 Z. BAARLINK: [Nuk ka përkthim]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Por çështja
25 është që kemi disa pyetje për të bërë, kështu që nuk e di se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 100

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 si të vijojmë më tej. Nuk e di në qoftë se dikush prej jush do
2 të marrë fjalë për të folur për dënimin, por i takon që në
3 qoftë se do të bënin këtë gjë, do të ndërhyjni shumë shpejt,
4 kështu që mbase do të ishte mirë për ne që të bëjmë disa
5 pyetje dhe pastaj t'jua japim juve fjalën më pas për të vijuar
6 me pjesën e fundit të parashtrimeve tuaja që kanë të bëjnë me
7 dënimin. Si mendoni?

8 Z. BAARLINK: [Nuk ka përkthim]

9 Z. AMBOS: [Përkthim] Faleminderit shumë, z. Baarlink, për
10 këtë prezantim thelbësor.

11 Kam në fakt disa pyetje, por shumë pyetje, por nuk kemi
12 kohë që të merremi me të gjitha këto. Më lejoni të filloj me
13 të parën, pyetjen e parë.

14 Dëgjova që thatë, dua të zbatojmë *in dubio pro reo*, për
15 sa i përket paragrafit 3 -- paragrafit 637, 638 të
16 aktgjykimit, Dhoma supozon, ligjin më të favorshëm, versionin
17 më të favorshëm të ngjarjeve, që viktima është vrarë nga
18 forcat serbe, apo jo? Dhe ju thatë, po citoj 638:

19 "Edhe sikur të shtënat me armë t'i atribuohen
20 ekskluzivisht forcave serbe..." pra kjo do të ishte versioni
21 më i favorshëm në përputhje me *in dubio pro reo*. Pajtoheni?

22 Z. BAARLINK: [Përkthim] Po.

23 Z. AMBOS: [Përkthim] Le të bisedojmë për këtë pak, që të
24 shkojmë në thelb, tamam në thelb të çështjes.

25 A do të thonit që një palë e tretë, aktor i tretë, që

1 vret viktimën, konsiderohet si veprim i ri, *novus actus* apo që
2 me fjalët e tjera siç e thatë në gjermanisht, italisht apo
3 spanjisht apo gjermanisht që në fakt është latinisht, është
4 thjesht një veprim ndërhyrës nga një agjent i pavarur i lirë.
5 A nuk është në këtë, kjo një situatë e tillë, një skenar i
6 tillë ligjor?

7 Z. BAARLINK: [Përkthim] Arsyeja për të cilën nënvizova
8 aspektet specifike të *novus actus*, ndërhyrja e aktit të ri
9 pra, është pasojë që vjen nga kjo, në juridiksionet
10 anglosaksone mund të jetë rasti që veprimi vullnetar i
11 vetëdijshëm i një pale të tretë që ndërhyr mund të prishë
12 zinxhirin e shkakësisë. Por ne kemi demonstruar që kjo nuk
13 ishte në atë.

14 Z. AMBOS: [Përkthim] Dua të kuptoj, që jemi në të njëjtën
15 fazë, pastaj do të flas për çështjen e ligjit humanitar,
16 ligjit zakonor ndërkombëtar që ju e përdorni shumë në vitin
17 1993. Në kohët e mëparshme më vonë, ligji zakonor ndërkombëtar
18 përkufizohej nga praktika në nivelin vendor, shtete-shtete.
19 Pra, shtetet ju e dini bënin deklaratë, siç e dini ne jemi
20 kundër imunitetit të shtetit, nuk mund të shënjestrojmë civilë
21 në Gaza nga Izraeli. Që ishte pra ligji zakonor ndërkombëtar.

22 Pastaj, ju në parashtrimet tuaja shumë elokumente cituat
23 dhe ligjin gjerman dhe të tjerë. Pra, në përputhje me ligjin,
24 nenin 3 të ligjit tonë, po merrni parasysh burimet e tjera
25 duke përfshirë parimet e përgjithshme. Dhe ajo që ju po bëni

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 102

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 është parimi që quhet *novo actus*, por nuk është zakonor. Mund
2 të jenë parime të përgjithshme.

3 Nuk po mohoj që nuk është çështja e ligjit e të drejtës
4 anglosaksone. Ne nuk kemi kohë që të shkojmë në hollësi, por
5 në emër, nën emërtim tjetër, ky parim zbatohet në
6 juridiksionet e të drejtës civile.

7 Pra, në qoftë se është parim që është parim i rëndësishëm
8 sa i përket justifikimit të përgjegjësisë penale për një
9 rezultat të caktuar, a mund të përdoret argumenti i ligjit
10 zakonor ndërkombëtar që ta heqim këtë nga debati, apo nuk
11 është pjesë e *actus reus* të vrasjes? Nëse ju thoni që ka një
12 akt të caktuar, një veprim të caktuar, një rezultat të caktuar
13 mes aktit, veprimit, dhe rezultatit, duhet të ketë një lidhje
14 mes veprimit dhe aktit.

15 Pra a duhet të përdorim ligjin ndërkombëtar, ligjin
16 zakonor ndërkombëtar për të biseduar, për të trajtuar parimin
17 në parashtrimin tuaj.

18 Z. BAARLINK: [Përkthim] Ju po zbatoni natyrisht ligjin
19 zakonor ndërkombëtar. Akuzat, vrasja, si krim lufte nën ligin
20 zakonor ndërkombëtar dhe ju duhet të ndiqni parimet, rregullat
21 e interpretimit, të parimeve, për të përcaktuar cilat janë
22 rregullat e zbatueshme të ligjit, nën, sipas ligjit zakonor
23 ndërkombëtar.

24 Dhe ju mund të përdorni siç e dini kryesisht në pajtim me
25 nenin 3, kryesisht jurisprudencën e tribunalëve *ad hoc*,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 103

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 gjykatave *ad hoc*. Ka raste të tilla, nuk është thjesht
2 shprehje e një standardi, por është, janë edhe raste të cilat
3 unë i përmenda sot, dhe në, i kemi përmendur në parashtrimet
4 tona me shkrim, ku kryerësit janë shpallur fajtorë dhe për
5 sepse, për vrasje, si kryes të drejtpërdrejtë në ato situata
6 ku një person tjetër përmes veprimit të vetëdijsëm dhe
7 vullnetar mund të ketë tërhequr këmbëzën e armës.

8 Pra, kryesisht ne ju kërkojmë juve, të nderuar Gjykatës,
9 që të shihni parimet e interpretimit normale, lidhur me këtë.

10 Z. AMBOS: [Përkthim] Dosjen tuaj, paragrafin 164, 166, ju
11 vetë flisni për shkakësinë faktuale, që është fajësia -- mund
12 të çojë në mbivërtetim. Dhe sot thoni që të gjitha
13 juridiksionet kanë elementë, ajo që quhet në ligjin, të
14 drejtën anglosaksone, shkakësia në të drejtën civile, flisni
15 për elementë ligjorë të kufizimit të shkakësisë, pra në fund
16 flisni për një atribuim të drejtë.

17 Ju vetë përmendni atribuimin e drejtë në parashtrimin
18 tuaj që mendoj është i përkryer për sa i përket debatit që
19 kemi tani për ligjin, për sa i përket të drejtës penale. A nuk
20 është atëherë çështja që, nuk është rasti që, mund t'ia
21 atribuojë, ku ju me të drejtë mund t'ia atribuoni vrasjen një
22 personi kur në rastin më të favorshëm të historisë në këtë
23 rast, vrasja mund të jetë kryer nga një person i tretë? Në
24 këtë rast forcat serbe.

25 A nuk do të ishte e drejtë në këtë situatë -- tani le të

1 flasim për drejtësi, arsyeshmëria. A nuk duhej të ishte e
2 arsyeshme dhe e drejtë që në këto rrethana, në qoftë se
3 supozojmë këtë skenar faktik, kemi problem këtu, natyrisht,
4 për skenarin faktik. Por në *in dubio pro reo*, duhet ta
5 supozojmë atë. Do të ishte, a nuk do të ishte e drejtë dhe e
6 arsyeshme, quajeni si të doni, *novus actus*, fakt ndërhyrës,
7 ngjarje ndërhyrëse. Është debat akademik, por sidoqoftë a nuk
8 do të ishte e drejtë që t'i atribuohet një personi këto
9 rrethana faktike, vrasja kur nuk mund të vërtetohet, kur nuk
10 jemi të bindur që personi ka qëlluar, që ai vetë e ka vrarë
11 drejtpërdrejt atë. A nuk duhet të ishte e drejtë që t'i bie
12 atij në barrë vrasja?

13 Z. BAARLINK: [Përkthim] Pa dyshim që po, sepse z. Mustafa
14 dhe bashkëkryesit e tij, vartësit e BIA-s e kanë patur atë nën
15 ndalim dhe ata kanë, kishin kontroll të plotë dhe dinin se
16 çfarë do të, mbi atë që do të ndodhte viktimja e vrasjes. Dhe
17 ata në vend që ta trajtonin atë në pajtim me Konventat e
18 Gjenevës e keqtrajtuuan me mjete vdekjeprurëse. Ata e lanë atë
19 në fakt në prag të vdekjes dhe konstatimet e Trupit Gjykues
20 janë të tilla që ai do të kishte vdekur në çdo rast në
21 vazhdimin normal të ngjarjeve, do të kishte vdekur.

22 Pra z. Mustafa pastaj refuzoi që ta lirojë atë, t'i
23 ofrojë trajtim mjekësor dhe ka qenë detyra e tij nën Konventat
24 e Gjenevës. E vetmja pyetje që mund të jetë e pazgjidhur është
25 si do të kishte ndodhur vdekja?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 105

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 Dhe në këto rrethana pse duhet të çlirohet dhe nga
2 përgjegjësia e tij penale? Është situatë e ngjashme në rastin
3 në Australi, Hallett, kur dallga e mbyti --

4 Z. AMBOS: [Përkthim] Kjo është, nuk është e krahasueshme
5 sepse kjo është natyra. Këto janë dy çështje, raste të
6 ndryshme, por gjithsesi nuk kemi kohë dhe duhet të ndalojmë.

7 Le t'ju pyes për format e përgjegjësisë penale sepse dhe
8 ju sot në parashtrimin tuaj folët për kontribut thelbësor,
9 ndihma, ndihma dhe inkurajimi.

10 E kam fjalën në qoftë se ju ngrini aktakuzë ndaj të
11 pandehurit si kryes jo si ndihmës, jo si ndihmës.

12 Në qoftë se arrijmë në përfundimin se nuk ka lidhje
13 ligjore të mjaftueshme për sa i përket kryerjes, themi po. Por
14 megjithatë është një lloj ndihme sepse sigurisht ai ka bërë
15 diçka dhe ka dhënë një kontribut që, tek rezultati
16 përfundimtar.

17 Z. BAARLINK: [Përkthim] Është një parashtrim alternativ
18 që është i vlefshëm për ju, të nderuar. Interpretimi i
19 drejtpërdrejtë i elementëve të shkakësisë së *actus reus* për
20 ndihmën dhe inkurajimin, një interpretim i drejtpërdrejtë
21 është me fjalë të ngjashme, me të njëjtat fjalë thelbësisht,
22 kontributi dhe shkak janë përdorur në mënyrë të barabartë,
23 pra është thelbësor.

24 Ne kemi theksuar në dosjen tonë që *actus reus* i ndihmës
25 dhe inkurajimit e përmbush këtë, bën këtë verifikim. Tani, që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 106

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 është, fakti që është kontribut thelbësor në kryerjen e
2 krimit, ne e kemi thënë që në jurisprudencë ju jep juve ndihmë
3 për sa i përket interpretimit se çfarë do të thotë, si mund të
4 përkufizohet kontributi thelbësor. Me fjalë të tjera zbatimi i
5 kriterit të kontributit thelbësor, qëndrimi jonë është që nuk
6 mund të shmanget konstatimi se ai ka dhënë kontribut thelbësor
7 në vdekjen. Ai ka lënë atë aty në prag të vdekjes dhe pastaj
8 që mund ta kishte larguar nga aty, mund të kishte vdekur
9 brenda ditësh dhe në fakt vdiq me shumë gjasë brenda pak
10 ditësh.

11 Pra, ky skenar faktik, duhet të përcaktojë, të vërtetojë
12 kontributin thelbësor, kriterin e shkakut thelbësor. Dhe kjo
13 është në dispozicionin tuaj.

14 Z. AMBOS: [Përkthim] Faleminderit shumë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Nuk kemi më
16 kohë, a mund të sugjeroj që të përfundoni parashtrimet tuaja
17 lidhur me përcaktimin e dënimit nesër.

18 Z. BAARLINK: [Përkthim] Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Tani mund
20 të ndërpresim seancën dhe të fillojmë nesër me parashtrimin
21 tuaj përfundimtar për përcaktimin e dënimit. Në qoftë se keni
22 diçka për të shtuar?

23 Z. BAARLINK: [Përkthim] Kemi një çështje që s'e kemi
24 trajtuar akoma -- që ka të bëjë me *mens rea* për vrasjen,
25 standardi për këtë të cilën ju e keni parashtruar në pyetjet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Seancë e apelit (Seancë e hapur)

Faqe 107

Parashtrime nga Zyra e Prokurorit të Specializuar

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F00031RED dhe F00040.

1 tuaja, por --

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Pastaj
3 natyrisht edhe Mbrojtësit të të akuzuarit do t'i jepet më
4 shumë kohë për parashtrimet e tij.

5 Atëherë propozimi im është që të ndërpresim seancën këtu.
6 Dhe shihemi nesër në orën 9.30. Nuk do të fillojmë me
7 parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, por do të fillojmë me
8 parashtrimet e fundit tuaja, pastaj me Mbrojtësin e Viktimave
9 dhe kthehemi tek Mbrojtësi i të akuzuarit dhe vetë z. Mustafa.
10 Seanca ndërpritet për sot.

11 --- Seanca mbyllet në orën 17.31

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25